

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5912
E enjte, 24 tetor 2019
çmimi 0.40 €

Palmeri: Koha nuk është
në anën e Kosovës,
hiqeni taksën



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FAQE 4-5

PROKURORIA THEMELORE NË PRIZREN KA PUBLIKUAR
EKSPERTIZËN E INSTITUTIT TË MJEKËSISË LIGJORE NË
LOZANË TË ZVICRËS PËR RASTIN E ASTRIT DEHARIT

Raporti zviceran konstaton se Astrit Dehari dyskohet se është vrarë



Konkluzionet e ekspertizës të Institutit të Mjekësisë Ligjore në Lozanë të Zvicrës për rastin e Astrit Deharit kanë konstatuar se i ndjeri dyskohet se është vrarë. Sipas raportit, hipoteza e vetëvrasjes së Astrit Deharit nëpërmjet mjeteve të caktuara nga mjekët ligjorë duket

pak e vërtetë. Bazuar në të gjeturat e këtij raporti, Prokuroria Themelore në Prizren ka konfirmuar se do ta vazhdojë hetimin e këtij rasti dhe do t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme. Pas pranimit të raportit, Avni Dehari, babai i Astritit, përgjegjës për vdek-

jen e djalit të vet i ka bërë udhëheqësit institucionalë të sistemit të drejtësisë. "Unë si prind tash pres nga organet e drejtësisë që të hapen hetimet dhe të kërkohet përgjegjësi për të gjithë ata që kanë marrë pjesë në vrasjen e Astritit", ka thënë Avni Dehari

Kërkohet nga KQZ-ja të ketë kujdes me votat e ardhura nga Serbia

Njohësi i proceseve zgjedhore dhe ish-anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Blerim Burjani, ka thënë se pa rezultatin e analizave dhe hetimeve të policisë nuk është dashur të verifikohen votat e ardhura me zarfe nga Serbia. Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re" se KQZ-ja duhet të ketë kujdes me këto vota. Sipas Burjanit, duhet të bëhet një vlerësim paraprak në Qendrën e Numërimit dhe Rezultatit (QNR) dhe, nëse



ka parregullsi, të hedhen poshtë votat e ardhura në zarfe nga Serbia



15.5 milionë euro kursime nëse qeveria e re zvogëlon postet ministore

FAQE 7

AKTUALE



VERIU I MITROVICËS,
SHËNJESTËR E LUFTIMIT TË
KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE
KONTRABANDËS F. 7

OSMANI DHE APOSTOLOVA
DISKUTOJNË PËR PËRBËRJEN
E QEVERISË SË RE F. 9

EKONOMI

KOSOVA, E 57-A NË RAPORTIN E
'TË BËRIT BIZNES' F. 9

KEDS-i ME 15 AKTIVITETE
SHËNON JAVËN EVROPIANE PËR
SIGURI E SHËNDET NË PUNË F. 9



SPORT

MAJLINDA, E ARTË
NË ABU DHABI F. 18



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Rama merr mbështetje nga Merkeli për hapjen e negociatave

TIRANË, 24 TETOR- Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama zhvilloi të enjten një bisedë telefonike me kancelaren e Gjermanisë, Angela Merkel, e cila ri-nënvizoi

qëndrimin e Gjermanisë në mbështetje të Shqipërisë. Kreu i qeverisë Rama u shpreh se gjatë bisedës me kancelaren diskutuan mbi ecurinë e

mëtejshme të përpjekjeve të përbashkëta për çeljen e negociatave për anëtarësim. "Gjatë një telefonate rreth 45 minuta me kancelaren Merkel

vendosëm të gjitha pikat mbi "i" për ecurinë e mëtejshme të përpjekjeve të përbashkëta për çeljen e negociatave për anëtarësim. Kancelarja ri-

nënvizoi qëndrimin e Gjermanisë në mbështetje të Shqipërisë. Faleminderit Angela", ka theksuar Rama.

Franca i ofron Ballkanit partneritet të veçantë në vend të anëtarësimit

Presidenti francez ka nisur konsultimet diplomatike në mënyrë jozyrtare për t'iu ofruar një lloj partneriteti të veçantë vendeve të Ballkanit, në vend të anëtarësimit të plotë në BE, veprim ky që shihet si strategji për të zëvendësuar në këtë mënyrë anëtarësimin me të drejta të plota



PRISHTINË, 24 TETOR - Presidenti i Francës Emmanuel Macron, i cili me veton e tij bllokoi çeljen e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut në BE, duket se ka në plan një tjetër skenar për rajonin.

Presidenti francez ka nisur konsultimet diplomatike në mënyrë jozyrtare për t'iu ofruar një lloj partneriteti të veçantë vendeve të Ballkanit, në vend të anëtarësimit të plotë në BE, veprim ky që shihet si strategji për të zëvendësuar në këtë mënyrë anëtarësimin me të drejta të plota.

Sipas propozimit, shteteve në fjalë do t'iu ofrohet mbështetje financiare, mundësi të veçanta për qasje në tregjet evropiane dhe përfitime të tjera në këmbim të një "tërheqjeje të heshur" nga anëtarësimi i plotë.

Sipas medieve serbe, ndaj Francës po ushtrohet presion nga partnerët e saj evropianë që të heqë dorë nga qëndrimi i vet

kokëfortë në samitin evropian të marsit e të lejojë që Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria t'i fillojnë bisedimet, dhe pastaj, çdo problem i mbetur të zgjidhet në periudhën e para-negociatave të pranimit.

Për këtë arsye, zgjedhjet në Maqedoninë e Veriut u caktuan në muajin prill, që të shihet ndërkohë nëse Bashkimi Evropian do të aprovojë vazhdimin e procesit në muajin mars.

Një propozim të ngjashëm i ka bërë Gjermania Ankarasë 10 vjet

më parë, duke i premtuar "partneritet të privilegjuar" në këmbim të anëtarësimit, gjë që dhe atëherë, kjo u pa si një mënyrë elegante për të hequr dorë nga anëtarësimi i Turqisë në Bashkimin Evropian.

Ndërkohë, pas debatit që zgjati deri në orët e vona të së mërkurës, Parlamenti Evropian ka miratuar të enjten rezolutën për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut.

Ishin 412 eurodeputetë nga 578 të pranishëm në seancë që votuan në favor të rezolutës ku

kërkohej hapje e negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian.

Ndër të tjera, në rezolutë, nënvizohet se Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut duhet t'i vazhdojnë reformat.

Parlamenti Evropian i bën thirrje Këshillit Evropian, të ndalojë frenimin e perspektivës së negociatave të pranimit dhe të kërkojë një propozim të Komisionit për një partneritet të ri me këto vende; po kështu të monitorojë përdorimin e

fondeve në Maqedoninë e Veriut dhe të sigurojë një raport të hollësishëm në Parlament; Udhëzoi presidentin e tij që t'ua përcjellë këtë rezolutë Komisionit, Këshillit, qeverive e parlamenteve të shteteve anëtare dhe qeverive e parlamenteve të Shqipërisë e Maqedonisë së Veriut.

Gjatë fjalës së saj, ministrja finlandeze për Çështjet Evropiane, Tytti Tuppuraine, shprehu zhgënjim për vendimin e KE-së, por shtoi se do të bëhen përpjekjet për një vendim tjetër.

Basha: Jam i gatshëm të përballem me Ramën në zgjedhje

TIRANË, 24 TETOR- Lideri i Partisë Demokratike, Lulzim Basha tha se nuk ka asnjë kompleks për t'u ulur dhe për të diskutuar për kapërcimin e krizës politike.

"Nuk kam asnjë kompleks as të ulem, as të diskutoj. Ka një problem. Për, të paktën, tri herët e fundit, kryeministri aktual e ka abuzuar vullnetin e opozitës dhe timin personal, për t'i zgjidhur problemet me dialog. Pra, është e qartë që kemi të bëjmë me mungesë vullneti, dëshire, do të thosha edhe kapacitetesh, nga kjo qeveri dhe nga ky kryeministër", u shpreh Basha.

I pyetur mbi kërkesën e vazhdueshme të PD-së për zgjedhje të parakohshme dhe se si do të arrihet kjo me Ramën kryeministër apo me qeveri transitore, Basha tha se "nuk kemi ne asnjë problem, as si opozitë, as si Partia Demokratike dhe as unë personalisht, sepse Edi Ramën e kam mundur edhe tek e tek dhe e kemi bërë atë betejë".

"E kam mundur dhe e mund çdo ditë. Nuk është problemi te njeriu, problemi është: do të ketë një palë zgjedhje të tjera si 2016-ta, 2017-ta, ku në vend që të votojnë qytetarët, në vend që të diktojë sovran

me votë, të diktojë krimi?! Oligarkët?! Avdylajt?", tha Basha.

I pyetur mbi takimin e opozitës së bashkuar për reformën zgjedhore, Basha tha se "janë vendosur piketat për çështje kryesore që kanë të bëjnë me reformimin e partive politike, ligji për partitë politike".

"Së dyti, problem shumë kryesor do të thosha më kryesori i reformës, ndarja e politikës nga krimi. Hapi tjetër ka të bëjë me garantimin e votës së lirë. Dhe këtu, natyrisht do të ketë propozim, një propozim prej vitit 2016 që Edi Rama e zvarrit që është ai për



votimin elektronik dhe numërimin elektronik si edhe identifikimin me shenjat e gishtërinjve të zgjed-

hësve për të, në mos zhdukur, për të zvogëluar mundësinë për abuzime", tha Basha. (atsh).

Kërkohet nga KQZ-ja të ketë kujdes me votat e ardhura nga Serbia

Njohësi i proceseve zgjedhore dhe ish-anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Blerim Burjani, ka thënë se pa rezultatin e analizave dhe hetimeve të policisë nuk është dashur të verifikohen votat e ardhura me zarfe nga Serbia. Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re" se KQZ-ja duhet të ketë kujdes me këto vota. Sipas Burjanit, duhet të bëhet një vlerësim paraprak në Qendrën e Numërimit dhe Rezultatit (QNR) dhe nëse ka parregullsi, të hedhen poshtë votat e ardhura në zarfe nga Serbia

tim të tillë, për shkaqe të sigurisë do të duhej të mos numërohen këto vota deri në ndryshimin e rrethanave të sigurisë. Është e çuditshme që me çdo kusht të numërohen fletëvotimet e tilla pa ndonjë siguri dhe me një rrezik për shëndetin e zyrtarëve. Pra, pa ndonjë siguri paraprake nuk duhet të hyhet në situatë të tillë, pastaj të shihet validiteti i fletëvotimit apo ekspertiza nëse janë vota të rregullta apo ka keqpërdorime apo gjera të tjera", ka deklaruar Burjani. Ai ka thënë se duhet të bëhet një vlerësim paraprak dhe nëse ka parregullsi duhet të hedhen poshtë votat e ardhura në zarfe nga Serbia. Sipas Burjanit, vendimi i KQZ-së për pranimin ose jo të këtyre votave duhet të vijë si rezultat i nxjerrjes së një konstatimi përfundimtar. "Nëse veç ka çështje të tilla ku fletëvotimet nuk janë të rregullta, duhet të hedhën poshtë dhe të shënohet në procesverbalet përfundimtare një raport i shkurtër me disa pika ku në mënyrë të qartë KQZ-ja tregon arsyet eventuale të pranimit të

këtyre fletëvotimeve si të rregullta ose të parregullta. Kjo varet nga KQZ-ja, megjithatë mendoj se ky vendim duhet të vijë si rezultat i nxjerrjes së një konstatimi përfundimtar. Së pari duhet të konstatohen a janë fletëvotimet të vlefshme, së dyti nëse konstatohet se zarfet janë në gjendje të rregullt të mbyllur dhe pa emra atëherë të procedohen. Por nëse konstatohet se ka probleme edhe të natyrave të tjera, siç mund të jetë dëmtimi i fletëvotimeve, mungesa e qartësisë në fletëvotim, mospërputhje në FRP, atëherë duhet të hedhen poshtë. Pra, duhet të bëhet një vlerësim paraprak në QNR. Nëse ka parregullsi siç është përfolur, se janë plotësuar nga një dorë, duhet të hedhen poshtë si jo të vlefshme për shkak të manipulimeve dhe organet e rendit të merren me këtë", është shprehur Burjani. Kundër pranimit dhe verifikimit të votave të ardhura në zarfe nga Serbia janë deklaruar edhe partitë politike në Kosovë të cilat e kanë quajtur jonormale numërimin e këtyre fletëvo-

timeve që shkaktuan probleme në shëndetin e punëtorëve të KQZ-së. Madje subjektet politike kanë tërhequr vëzhguesit e tyre në kohën kur është bërë procesi i verifikimit.

Por, zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka deklaruar se verifikimi i këtyre votave është i domosdoshëm. "Ky vlerësim është i domosdoshëm pasi ka për qëllim të identifikojë një fletëvotim me personin që e ka dërguar pakon. Pra, që ta dimë nëse fletëvotimi i dërguar është nga një votues i regjistruar suksesshëm si votues jashtë vendit", ka thënë Elezi.

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 24 TETOR - Ndonëse dhjetëra punonjës në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) kanë pasur reaksione alergjike pas hapjes së zarfeve me fletëvotime të ardhura nga Serbia megjithatë, nën masa të shtuara të sigurisë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka verifikuar këto vota. Por njohësi i çështjeve zgjedhore dhe politike, Blerim

Burjani, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) duhet të tregohet i kujdesshëm në raport me votat e ardhura nga Serbia. Ai ka thënë se pa rezultatin e analizave dhe hetimeve të policisë nuk është dashur të verifikohen këto vota. "Ka disa dilema në këtë drejtim po qe se është bërë analizë mjekësore e zyrtarëve të KQZ-së, se cili është konstatimi mjekësor, ka apo nuk ka helmime? Nëse veç ka konsta-

Nis numërimi i votave me kusht dhe votave të personave me nevoja të veçanta

Zëdhënësi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valmir Elezi, ka bërë me dije se pasditen e së enjtes ka filluar numërimi i votave me kusht dhe i votave të personave me nevoja të veçanta. Ai ka treguar se janë 24 804 vota me kusht, kurse 2 015 vota të personave me nevoja të veçanta. "Ka filluar numërimi i votave me kusht dhe votave të personave me nevoja të veçanta. Numërimi i tyre është faza e radhës pas verifikimit të tyre. Numri i zarfeve me fletëvotime me kusht në nivel vendi ka qenë 26 382 dhe pas verifikimeve janë konfirmuar 24 804, ndërsa janë refuzuar 1 578. Ndërsa vota të personave me nevoja të veçanta në nivel vendi kanë qenë 2 142, por pas procesit të verifikimit janë konfirmuar 2 015 dhe janë refuzuar 127. Pra, do të numërohen 24 804 vota me kusht dhe 2 015 vota të personave me nevoja të veçanta, që në total bëjnë 26 819", ka deklaruar Elezi.



Haradinaj takon ambasadorin italian, flasin për mbarëvajtjen e zgjedhjeve të 6 tetorit

Prishtinë, 24 tetor (ER) - Kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, ka prituri të enjten në takim ambasadorin e Italisë në Kosovë, Piero Cristoforo Sardi, me të cilin kanë biseduar për mbarëvajtjen e zgjedhjeve të 6 tetorit. Po ashtu, Haradinaj ka theksuar se në këtë takim kanë

biseduar për zhvillimet e fundit në vendin tonë. "Patëm një bashkëbisedim me ambasadorin e Republikës së Italisë në Kosovë, Piero Cristoforo Sardi, për mbarëvajtjen e zgjedhjeve të 6 tetorit të cilat pasqyrojnë pjekuri të lartë politike dhe demokratike, si dhe

për zhvillimet e fundit në Kosovë. Përkushtimi institucional do të vazhdojë në temat e rëndësishme, siç është liberalizimi i vizave, dialogu, integritet euroatlantike, në të cilat mbështetja e Italisë është e pazëvendësueshme", ka thënë Haradinaj pas takimit.



Prokuroria Themelore në Prizren ka publikuar ekspertizën e Institutit të Mjekësisë Ligjore në Lozanë të Zvicrës për rastin e Astrit Deharit.

Raporti zviceran konstaton se Astrit Dehari...

Konkluzionet e ekspertizës të Institutit të Mjekësisë Ligjore në Lozanë të Zvicrës për rastin e Astrit Deharit kanë konstatuar se i ndjeri dyshohet se është vrarë. Sipas raportit, hipoteza e vetëvrasjes së Astrit Deharit nëpërmjet mjeteve të caktuara nga mjekët ligjorë duket pak e vërtetë. Bazuar në të gjeturat e këtij raporti, Prokuroria Themelore në Prizren ka konfirmuar se do ta vazhdojë hetimin e këtij rasti dhe do t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme. Pas pranimit të raportit, Avni Dehari, babai i Astritit, përgjegjës për vdekjen e djalit të tij i ka bërë udhëheqësit institucionalë të sistemit të drejtësisë. "Unë si prind tash pres nga organet e drejtësisë që të hapen hetimet dhe të kërkohet përgjegjësi për të gjithë ata që kanë marrë pjesë në vrasjen e Astritit", ka thënë Avni Dehari



**EPOKA
ERE** **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 24 TETOR - Prokuroria Themelore në Prizren ka publikuar të enjten konkluzionet e ekspertizës të Institutit të Mjekësisë Ligjore në Lozanë të Zvicrës për rastin e Astrit Deharit, i cili ka vdekur në nëntor të vitit 2016 teksa po mbahej në Qendrën e Paraburgimit në Prizren. Raporti zviceran ka konstatuar se Astrit Dehari dyshohet se është vrarë. Sipas raportit, hipoteza e vetëvrasjes së Astrit Deharit nëpërmjet mjeteve të caktuara nga mjekët ligjorë duket pak e vërtetë. "Ashtu siç është thënë në ekspertizën tonë

E1180001, ne kemi dyshime që lidhen me rrethanat e vdekjes së z. Astrit Dehari. Në fakt, hipoteza e një vetëvrasjeje e z. Astrit Dehari përmes mjeteve të caktuara nga mjekët ligjorë duket pak e vërtetë dhe intervenimi i një personi të tretë në proces fatal duhet të kihet parasysh", është thënë në konkluzionin e parë të raportit të ekspertizës së Institutit të Mjekësisë Ligjore në Lozanë të Zvicrës për rastin e Astrit Deharit, të cilin prokuroria Themelore në Prizren ua ka dorëzuar familjarëve dhe avokatit të Astritit.

Raporti konstaton se analizat e tyre kanë mundësuar të vënë në dritë një profil të ADN-së mbi

mostrën e përshkruar nga ekspertët e Kosovës. "Analizat e ADN-së të kryera në laboratorët tanë kanë mundësuar të qesin në dritë një profil të ADN-së mbi mostrën e përshkruar nga ekspertët e Kosovës siç thuhet se përmban pak ose shumë pak ADN", është thënë në raport. Në konkluzionin e fundit raporti rekomandon se për ta zbardhur rastin është i nevojshëm një

hetim i ri. "Nga ajo çfarë u tha, ne vlerësojmë se një hetim i ri është i nevojshëm për t'i qartësuar rrethanat e vdekjes së z. Astrit Dehari. Ekipet tona dhe laboratorët tanë janë në dispozicion të hetuesve të ngarkuar me çështjen", është thënë në këtë raport. Prokuroria Themelore në Prizren ka bërë me dije se do t'i vazhdojë hetimet për zbardhjen e rastit. "Bazuar në të gjeturat e këtij

raporti, Prokuroria do të vazhdojë hetimin e këtij rasti dhe do t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme, ku do t'i dëgjojë edhe ekspertët e Institutit të Mjekësisë Ligjore në Lozanë, si dhe ekspertët e Institutit të Mjekësisë Ligjore në Kosovë, për sqarimin e raporteve të tyre dhe, nëse është e domosdoshme, do të bëhet një superekspertizë jashtë vendit në bashkëpunim dhe koordinim me partnerët ndërkombëtarë në mënyrë që të sqarohen rrethanat dhe shkaktarët e vdekjes", ka bërë me dije Prokuroria Themelore në Prizren.

Prokurori i Shtetit ka siguruar familjen Dehari dhe opinionin publik se në bazë të kompetencave dhe autorizimeve kushtetuese dhe ligjore do të zhvillojë hetime profesionale deri në zbardhjen e plotë të këtij rasti.

Prindërit dhe avokati i kërkojnë drejtësi për Astritit

Avokati i familjes së Astrit Deharit, Tomë Gashi, pas pranimit të raportit nga Instituti Zviceran, Qendra Universitare e Mjekësisë Ligjore në Lozanë në lidhje me rastin e Astrit Deharit, ka thënë se, në bazë të të gjeturave të raportit, është vërtetuar ajo që është ditur që nga dita e parë, se Astrit Dehari më 05. 11. 2016 është vrarë në rrethana të pasqaruara deri më tani në Qendrën e Paraburgimit në Prizren. Gashi ka pohuar se tani është detyrë e Prokurorisë dhe e



astin e Astrit Deharit

'it Dehari dyshohet se është vrarë



nuk ka ndodhur nga ai dhe nga aktivitetet e tjerë të Lëvizjes Vetëvendosje", ka deklaruar Gashi. Ai ka bërë me dije se Astrit Dehari është mbajtur për 78 ditë në Qendrën e Paraburgimit në Prizren dhe për këto ditë sa është mbajtur në paraburgim ai asnjëherë zyrtarisht nuk është marrë në pyetje nga Prokuroria. Sipas tij, tani shteti duhet të kërkojë drejtësi për Astritin.

Pas pranimit të raportit, Avni Dehari, babai i Astritit, përgjegjës për vdekjen e djalit të tij i ka bërë udhëheqësit institucionalë të sistemit të drejtësisë. "Ende nuk e kemi lexuar raportin por, sipas konkluzioneve, na është thënë se është vrasje. Në rastin e Astritit që e kanë vrarë në burgun e Prizrenit, përgjegjës, përpos prokurorit Sylë Hoxha dhe ministres së atëhershme të Drejtësisë, Dhurata Hoxha, janë edhe shumë të tjerë", ka thënë Avni Dehari para mediave. Ai ka thënë se pret nga organet e drejtësisë që të hapen hetimet dhe të dihen kryerësit e vrasjes së djalit të tij. "Unë si prind tash pres nga organet e drejtësisë që të hapen hetimet dhe të kërkohej përgjegjësi për të gjitha ata që kanë marrë pjesë në vrasjen e Astritit", ka thënë Avni Dehari. Nëna e Astritit, Xhemile Dehari, ka pohuar se: "Ne e kemi ditur rastin që Astritin e kanë vrarë në burg, por juridikisht nuk ka qenë e mbyllur, edhe pse janë lënduar se brenda 15 ditëve do ta përmbyllin para tri vjetëve, por u bënë tre vjet e neve na kanë zier në kazan si familje".

Pak fjalë ka thënë edhe gruaja e Astritit, Arta, e cila mes lotësh ka kërkuar që të vendoset drejtësi. "Unë besoj se drejtësia duhet të merret me këtë punë. Dhe besoj se drejtësia do të bjerë në vend", ka deklaruar ajo.

III. Konkluzionet

Në bazë të të gjitha elementeve që kemi në dispozicion dhe në vazhdimin e analizës së kryer në laboratorët tona ne mund të pranojmë konkluzionet e më poshtme :

1. Ashtu siç është thënë në ekspertizën tonë EI180001, ne kemi dyshime që lidhen me rrethanat e vdekjes së z. DEHARI Astrit. Në fakt hipoteza e një vetëvrasjeje e z. DEHARI Astrit përmes mjete të caktuara nga mjekët ligjor duket pak e vërtetë dhe intervenimi i një personi të tretë në proces fatal duhet të kihet parasysh.
2. Analizat e ADN-së të kryera në laboratorët tona kanë mundësuar të vejnë në dritë një profil të ADN-së mbi mostrën e përshkruar nga ekspertët e Kosovës siç thuhet se përmbanë pak ose shumë pak ADN.
3. Nga ajo çfarë u tha, ne vlerësojmë se një hetim i ri është i nevojshëm për t'i qartësuar rrethanat e vdekjes së z. DEHARI Astrit. Ekipet tona dhe laboratorët tona janë në dispozicion të hetuesve të ngarkuar me çështjen.

Materiali që është vënë në dispozicion nga CURML do të ruhet në pritje të udhëzimeve të reja nga ana e mandatit ton.

(nënshkrimi i palexueshëm)

Prof Dr med. T. FRACASSO
Specialist FHM në mjekësi ligjore
Mjek-shef

(nënshkrimi i palexueshëm)

20.06.19

Prof. Dre med. S. GRABHERR
Specialist FHM në mjekësi ligjore
Drejtoreshë e CURML

Dre s Sc V. CASTELLA , PD, MER
(nënshkrimi i palexueshëm)
Geneticien forensique SSML

Edhe Lëvizja Vetëvendosje ka kërkuar drejtësi për ish-aktivistin e vet. Në reagimin për media, Lëvizja Vetëvendosje ka vlerësuar se Astrit Dehari është vrarë veç pse ka qenë aktivist i kësaj lëvizjeje. "Astrit Dehari është vrarë për shkak se ka qenë aktivist i Lëvizjes Vetëvendosje. Këtë e ka thënë edhe raporti i ekspertëve të mjekësisë ligjore nga Shqipëria e Mbretëria e Bashkuar. Këtë e thotë tani edhe raporti i ekspertëve të Qendrës Universitare Romande për Mjekësi Ligjore (CURML) në Lozanë të Zvicrës. Këtë e ka thënë vetë trupi i Astrit Deharit", është thënë në reagimin e LV-së, duke kërkuar prej organeve të drejtë-

sisë hetim sa më të shpejtë ligjor. "Prokuroria e ka obligim ligjor dhe njerëzor që t'i fillojë hetimet për rastin, në mënyrë që përgjegjësit e këtij krimi monstruoze, që e privoi aktivistin 26-vjeçar Astrit Dehari nga jeta, të vihen të gjithë para drejtësisë. Drejtësia nuk duhet të ndalet para fajtorëve, sado lart që mund të ndodhen ata në hierarkinë e

pushtetit. Po ashtu, duhen hetuar edhe ata që, përkundër dhimbjes së familjes, shokëve dhe mbarë opinionit publik, u bënë mjet i dezinformimit menjëherë pas vrasjes së Astritit në burg. Cili ishte qëllimi i atyre që me çdo mjet, edhe duke gënjyer e duke i ndërruar fjalët, donin ta mbulonin krimin si vetëvrasje?", ka vlerësuar LV-ja.

shtetit të Kosovës që ta gjejnë vrasësin e Astrit Deharit. "Në bazë të këtyre raporteve të Institutit Zviceran vërtetohet ajo që është ditur që nga dita e parë e vrasjes së Astrit Deharit më 05. 11. 2016 që ai është vrarë në rrethana të pasqaruara deri me tani në Qendrën e Paraburgimit në Prizren. Tani është detyrë e Prokurorisë dhe e shtetit të Kosovës që ta gjejnë vrasësin e Astrit Deharit. Është ditur se Astrit Dehari është varë vetëm për një arsye, se ka qenë aktivist i Lëvizjes Vetëvendosje dhe është vrarë duke tentuar që t'i merren deklarata vetinkriminuese për kinse gjuajtjen e Kuvendit të Republikës së Kosovës, që kurrë

Lumezi kërkon ndihmë nga ShBA-ja për hetimin e vdekjes së Astritit

Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ka deklaruar se do të kërkojë ndihmë nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë për hetimin e vdekjes së Astrit Deharit. "Kemi kërkuar prej Ambasadës Amerikane që të na sjellin ndonjë prokuror apo dikë që mund të na ndihmojë në hetimin e këtij rasti, në mënyrë që ta zbardhim të vërtetën", ka thënë Lumezi. Ai ka treguar se e njëjta prokurori do ta vazhdojë ta hetojë rastin. "E njëjta prokurori do ta hetojë rastin, sepse kompetenca territoriale është e Prizrenit dhe s'mundet ndonjë prokurori tjetër. Por do

ta kërkojmë edhe ndihmën, ndoshta të partnerëve ndërkombëtarë, të na ndihmojnë në hetimin e këtij rasti", u shpreh kryeprokurori Lumezi. Por, Lëvizja Vetëvendosje e ka kundërshtuar një gjë të tillë. Albulena Haxhiu, zyrtare e lartë e kësaj partie, në një konferencë për medie ka kërkuar që rastin ta marrë Prokuroria Speciale. "Ne kërkojmë që Prokuroria e Prizrenit të mos merret me hetimin e vrasjes së Astrit Deharit. E njëjta prokurori nuk mundet pasi që ka humbur besimin dhe pasi që është përfshirë në këtë rast të sjellë hetime objektive. Ne kërkojmë që Prokuroria Speciale

ta marrë rastin", ka deklaruar Haxhiu. Bashkë me Astrit Deharin ishin arrestuar katër aktivistë të atëhershëm të Lëvizjes Vetëvendosje, Frashër Krasniqi, Adea Batusha, Atdhe Arifi dhe Egzon Haliti. Ata dyshoheshin për sulmin me mjet shpërthyes kundër Kuvendit të Kosovës që kishte ndodhur në mbrëmjen e 4 gushtit të vitit 2016. Me kërkesë të familjes Dehari, në maj të vitit 2017, Ministria e Drejtësisë kishte treguar se ka vendosur që ekspertizën për këtë rast ta kryejë Qendra Universitare e Mjekësisë Ligjore në Zvicrën Franceze.

Zëvendësministri i Mbrojtjes: Kosova është e përkushtuar drejt integritimeve në NATO

PRISHTINË, 24 TETOR (ER) - Zëvendësministri i Mbrojtjes, Burim Ramadani, ka pritur të enjten në Ministrinë e Mbrojtjes ambasadorin e Republikës së Turqisë në Kosovë, Çağrı Sakar, me të cilin ka biseduar për zhvillimet e përgjithshme aktuale në Kosovë dhe mbi raportet mes dy shteteve partnere. Zëvendësministri Ramadani ka thënë se në zhvillimin e përgjithshëm në Kosovë, sikurse edhe në rrugën tonë veriatlantike, mbështetja e

Turqisë është e rëndësishme. "Kosova është e përkushtuar për zhvillimin e gjithëmbarshtëm, avancimin e rrugës së saj drejt integritimeve në NATO dhe në prosperitetin e të gjithë qytetarëve të saj pa dallime", ka thënë zëvendësministri Ramadani. Nga ana e tij, ambasadori turk në Kosovë, Çağrı Sakar, vlerësoi bashkëpunimin me Kosovën në fusha të ndryshme, duke theksuar vazhdimin e mbështetjes për Kosovën nga ana e Republikës së Turqisë.



Veriu i Mitrovicës, shënjestër e luftimit të krimit të organizuar dhe kontrabandës

MITROVICË, 24 TETOR - Autoritetet në Kosovë janë përqendruar në luftimin e kontrabandës dhe krimit të organizuar në pjesën veriore të Kosovës. Të enjten Policia e Kosovës, me urdhër të Prokurorisë së Kosovës, ka zhvilluar një operacion në veri të Mitrovicës, ku ka arrestuar tre zyrtarë policorë.

Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) ka njoftuar se aksioni i së enjtes është vazhdimësi e operacionit të zhvilluar në muajin maj të këtij viti të koduar me emrin "Kontrabanda". Si rezultat i këtij operacioni, i cili po zhvillohet që nga muaji maj, deri më tani janë arrestuar 25 persona. "Arrestimi i tre të dyshuarve (një toger policor, një rreshter dhe një zyrtar policor) është realizuar me urdhëresë të Prokurorisë Speciale, me dyshimin se të njëjtit kanë kryer veprat penale "Krim i organizuar" dhe "Keqpërdorim i pozitës zyrtare". Të arrestuarit do të intervistohen nga hetuesit e Inspektoratit Policor të Kosovës në bashkëpunim me prokurorin kompetent", thuhet në komunikatën e Inspektoratit Policor. Zyrtarëve të arrestuar u vendim të prokurorit kompetent u është caktuar masa e ndalimit për 48 orë.

Pjesa veriore e Kosovës, e cila shtrihet në kufi me Serbinë, sipas Doganës së Kosovës, vazhdon të

mbetet zona më e prekur nga krimi i organizuar dhe kontrabanda. Ndonëse sipas zëdhënësit të Doganës së Kosovës, Adriatik Stavileci, në përgjithësi niveli i kontrabandës ka shënuar rënie nëse bëhen krahasime përgjatë viteve. "I kemi disa pjesë në të cilat ushtrime kontrolle më të shpeshta siç është pjesa e Kosovës veriore. Aty kemi kontrabandë, por jo kontrabandë me vlera të larta, por me mallra në vlera të ulëta. Po ashtu kemi te pikëkalimi kufitar 'Dheu i Bardhë', për shkak të terrenit në atë pjesë ku kufiri Serbi - Kosovë dhe anasjelltas kalohet shumë lehtë. Edhe në pikat e tjera që lidhin Kosovën me Shqipërinë është zona ku ka kontrabandë", ka thënë Stavileci për "Radion Evropa e Lirë".

Dogana e Kosovës dhe përfaqësues të bizneseve thonë se qëkur Qeveria e Kosovës vendosi takson doganore 100 për qind ndaj importeve nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina (më 21 nëntor 2018), është rritur tendenca për kontrabandim më të madh të mallrave në veri të vendit.

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se stimulimi i kontrabandës nga ana e Serbisë ka ndikuar në shkallën e kontrabandës në veri të vendit. "Kontrabanda është më e përhapur në veriun e



Kosovës për shkak se ka pasur më pak kontroll dhe kapacitetet e rendit dhe ligjit janë të limituara në këtë pjesë. Unë besoj se duhet të ketë një task-forcë permanente që e trajton këtë. Duhet të rriten kapacitetet institucionale për luftim të kontrabandës jo vetëm në këtë pjesë, por në çdo pjesë të vendit", ka thënë Rukiqi.

Autoritetet në Kosovë në vazhdimësi kanë theksuar se vazhdojnë përkushtimin e tyre për t'i luftuar pa kompromis korrupsionin dhe krimin e organizuar në veri të vendit si dhe për

ta shtrirë kushtetutshmërinë dhe sundimin e ligjit në gjithë territorin e Republikës.

Gjatë muajit maj Policia e Kosovës kishte zhvilluar një operacion në veri dhe jug të Mitrovicës, i cili kishte rezultuar me ndalimin e 19 zyrtarëve policorë dhe të disa qytetarëve. Edhe atë kohë, siç kishin njoftuar zyrtarët e Prokurorisë Speciale të Kosovës dhe Policisë së Kosovës, aksioni policor kishte për qëllim luftimin e krimit dhe kontrabandës. Gjatë aksionit policor nga të shtënat me armë zjarri ishte plagosur një zyrtar policor,

ndërkaq katër zyrtarë të tjerë policorë patën marrë lëndime të lehta gjatë zbatimit të detyrave. Operacioni policor kishte përfshirë disa rajone të ndryshme, si komunat Zveçan, Zubin Potok, Leposaviç, Mitrovicë e veriut, Mitrovicë e Jugut, Skenderaj dhe Drenas. Drejtorja e Policisë së Kosovës për veri të Mitrovicës, gjatë një aksioni tjetër të enjten, ka arrestuar edhe tre persona (civilë) të dyshuar për veprë kriminale grabitje. Ky aksion ishte i ndarë me atë të zhvilluar kundër krimit të organizuar në veri.

'Let's Do It Kosova' mbjellë qindra fidanë në dhjetë oborre të shkollave në Viti

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

VITI, 24 TETOR - Në kuadër të projektit "Ngritja e kapaciteteve të nxënësve në fushën e edukimit mjedisor dhe rivitalizimi i hapësirave shkollore", i cili bashkëfinancohet nga "Let's Do It Kosova" dhe Komuna e Vitisë, ka filluar faza e dytë e projektit, ajo e rivitalizimit të hapësirave shkollore, me ç'rast do të mbillen qindra fidanë në 20 oborre të shkollave të kësaj komune, në dhjetë prej të cilave u mbollën dje.

Drejtori ekzekutiv i "Let's Do It", Luan Hasanaj, u shpreh se ky është vetëm një prej aktiviteteve në bashkëpunim me Komunën e Vitisë, të cilat do të vazhdojnë në mënyrë që të ngritët vetëdija e qytetarëve dhe e nxënësve për kujdesin ndaj ambientit jetësor dhe hapësirave publike në mënyrë që të rritet vetëdija e qytetarëve, në këtë rast më së shumti e nxënësve të cilët janë nëpër shkolla.

Hasanaj ka thënë se fokus i "Let's Do It" është bashkëpunimi me ato komuna të cilat tregojnë vullnet dhe angazhim për ta përmirësuar situatën mjedisore, e Viti është njëra ndër to. "Ne si organizatë do



të interesohemi. Në fakt fokusi ynë është të bashkëpunojmë me komuna të cilat tregojnë vullnet dhe shohim angazhim më të madh për ta përmirësuar situatën mjedisore. Këtë e kemi parë në Viti. Viti është në fokusin tonë edhe për vitin që vjen, kështu që do të kemi shumë e shumë edhe drunj, edhe aktivitetet të tjera të cilat do të vijnë këtë vit, por edhe vitin e ardhshëm", ka deklaruar Hasanaj.

Kryetari i Komunës së Vitisë, Sokol Haliti, ka pohuar se ky vit i cili është shpallur vit ambiental dhe i mbrojtjes së pyjeve në Komunën e Vitisë po përmbyllet suksesshëm me mbjellje dhe se Komuna e Vitisë po punon gjithëmbarshtëm që vetëdija e vazhdimësisë ambientale të forcohet. "Aktiviteti i sotëm është një tregues për këtë", ka thënë ai. Haliti ka falënderuar Ministrinë e Mjedisit, në veçanti "Let' Do It" për bashkëpunimin

në sferën ambientale dhe u shpreh se bashkërisht kanë arritur që viti 2018 dhe viti 2019 të jenë të suksesshëm për Komunën e Vitisë në këtë sferë. "Ne po dëshirojmë të përmbyllim suksesshëm këtë vit ambiental, pastër dhe me mbjellje të drunjve e bimëve dekorative, sepse ju e dini se e kemi pasur të shpallur vit ambiental dhe të mbrojtjes së pyjeve vitin 2019, por edhe vitin 2018. Ne e kemi imperativ ta bëjmë Vitin të

bukur, të gjelbër e të pastër", ka theksuar Haliti.

Drejtoresha e Drejtorisë së Arsimit e kësaj komune, Fatbardha Emini, ka falënderuar kryetarin e komunës dhe drejtorin ekzekutiv të "Let's Do It" për qasjen pozitive dhe ka thënë se ky është vetëm një nga projektet i cili është duke u zbatuar. "Ciklin e parë e kemi pasur ngritjen e kapaciteteve sa i përket edukimit për mbrojtjen e ambientit, me trajnime të nxënësit e mësimitdhënësit. Tani jemi në komponentin e dytë, që ka të bëjë me pjesën e rregullimit të kopshteve të shkollave. Më lejoni që në emër të Drejtorisë së Arsimit dhe të gjithë drejtorëve të shkollave ta falënderoj kryetarin dhe drejtorin e 'Let's Do It Kosova' që e kanë një qasje shumë pozitive që sektorin e arsimit ta mbështesin", ka thënë ai. Të mërkurën është nënshkruar edhe pranimi i grantit të performancës i cili është ndarë për Komunën e Vitisë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si rezultat i suksesit të treguar nga kjo komunë gjatë fushatës tremujore të vitit të kaluar "Ta Pastrojmë Kosovën 15 shtator - 15 dhjetor", të implemtuar nga "Let's Do It" në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës.

Palmeri: Koha nuk është në anën e Kosovës, hiqeni taksën

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 24 TETOR - I dërguari i posaçëm amerikan për Ballkanin, Matthew Palmer, ka thënë se Kosova duhet ta formojë qeverinë e re sa më shpejt dhe të kthehet në tryezën e bisedimeve me Serbinë, sepse "koha nuk është në anën e saj".

Palmeri ka folur para Komitetit të Jashtëm të Senatit, në një seancë kushtuar rajonit të Ballkanit. Ai ka pohuar se Shtetet e Bashkuara e inkurajojnë edhe Kosovën, edhe Serbinë që të bëjnë lëshime, për të arritur një marrëveshje për normalizimin e marrëdhënieve.

Palmeri i bëri thirrje Kosovës që ta anulojë taksën e vendosur ndaj prodhimeve të importuara nga Serbia, vitin e kaluar, e cila edhe është bërë shkak për ndërprerjen e bisedimeve. Nga Serbia, ai kërkoi që të heqë dorë nga "fushata për ta delegitimuar Kosovën në komunitetin ndërkombëtar".

Në muajin gusht, Departamenti Amerikan i Shtetit e ka emëruar Palmerin përfaqësues të posaçëm për Ballkanin

Perëndimor, me mandat për ta ndihmuar integrimin e rajonit në institucionet perëndimore.

Ndërkaq në fillim të këtij muaji presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, ka emëruar Richard Grenellin të dërguar të posaçëm për dialogun Kosovë - Serbi. Grenell është edhe ambasador në Gjermani.

Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian në vazhdimësi kanë kërkuar pezullimin apo edhe shfuqizimin e kësaj takse pasi ajo u konsiderua si shkak që Serbia të tërhiqet nga tavolina e bisedimeve me Kosovën deri në heqjen e tarifave doganore apo taksës.

Debatet rreth taksës kanë vazhduar që nga vendosja e saj më 21 nëntor të vitit të kaluar. Dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ka nisur në vitin 2011. Bashkimi Evropian, si ndërmjetësues i këtij procesi, ka kërkuar nga të dyja palët që të arrijnë një marrëveshje për normalizimin e plotë të marrëdhënieve, e cila do t'u hapte rrugë të dyja shteteve në perspektivën evropiane.

Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Blerim Reka, ka thënë se ka ardhur koha që



ShBA-ja ta ndërmjetësojë dialogun midis dy shteteve Kosovë - Serbi. Reka ka theksuar për "Epokën e re" se dialogu i Brukselit nuk duhet të vazhdojë më tutje. "Dialogu midis Kosovës dhe Serbisë duhet të rikonfigurohet në një format dhe mandat të ri me mediatorë dhe parime të

reja", ka thënë ai.

Reka ka shtuar se parimi i parë pa të cilin nuk bën të rifillojë çfarëdo dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të jetë parimi i negociimit të dy shteteve dhe jo i negociimit të një shteti dhe një etniteti me fusnotë. "ShBA-ja duhet ta ndërmjetësojë

këtë dialog. Edhe ashtu ishte mediatore e paqes së Dejtonit. Pa amerikanët nuk do të mund të arrihej as procesi i Rambujesë dhe as Marrëveshja e Ohrit. Është koha që ShBA-ja ta zëvendësojë BE-në për ndërmjetësimin e dialogut Kosovë - Serbi", ka thënë Reka.

Aktakuzë ndaj katër personave për vjedhjen e 65 mijë eurove

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

GJILAN, 24 TETOR - Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda, të enjten ka ngritur aktakuzë ndaj katër personave, të pandehurve F. S., L. M., L. H. dhe S. H., të cilët, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror, kanë kryer veprat penale "grabitje" dhe "grabitja në tentativë". Sipas aktakuzës, të pandehurit F. S., L. M., L. H. dhe S. H., më 3 korrik, rreth orës 18:30 minuta, në Gjilan, në bashkëveprim dhe me përgatitje paraprake, kanë kryer grabitje, në atë mënyrë që të pandehurit L. H. dhe S. H. i kanë udhëzuar të pandehurit L. M. dhe F. S. në shtëpinë ku do ta kryenin grabitjen, të cilët, të armatosur



dhe të maskuar, kanë hyrë në shtëpinë e të dëmtuarit S. S., ku nën kanosje dhe ushtrim të dhunës ndaj të dëmtuarës H. S., marrin para në shumën prej 65

000 eurosh, 1 000 franga si dhe sasi të konsiderueshme ari, me ç'rast, pas grabitjes, së bashku me një person tjetër janë mbledhur në banesën e të pandehurit L. M.

në Fushë-Kosovë, për t'i ndarë paratë e vjedhura.

Gjithashtu, të pandehurit F. S. dhe L. M. më 11 korrik, rreth orës 18:05 minuta, në Postën e

Kosovës, në rrugën "Balzaku" në Gjilan, të maskuar dhe të armatosur me një revole kanë kryer grabitje, ashtu që fillimisht i sulmojnë fizikisht punëtorët e kësaj pike të Postës, e më pas nga arka marrin 300 euro dhe largohen nga vendi i ngjarjes.

Të pandehurit F. S. dhe L. M. akuzohen edhe për veprën penale "Grabitja në tentativë" pasi që më 4 qershor 2019, rreth orës 02:10 minuta, në objektin e fabrikës "Fluidi", në fshatin Velekincë, kanë tentuar të kryejnë grabitje, ashtu që fillimisht me forcë hapin derën e fabrikës, mirëpo për shkak të zurmës e cila është shkaktuar gjatë hapjes së derës, të njëjtit janë hetuar nga sigurimi, ku pas kësaj të pandehurit kanë shkrepur armët dhe janë larguar nga vendi i ngjarjes.

Osmani dhe Apostolova diskutojnë për përbërjen e qeverisë së re

PRISHTINË, 24 TETOR (ER) - Nënkryetarja e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Vjosa Osmani, të enjten ka takuar përfaqësuesen e posaçme të BE-së dhe shefen e zyrës së BE-së në Kosovë, Nataliya Apostolova. Temë diskutimi ishin situata aktuale politike në Kosovë, pri-

oritetet e LDK-së dhe diskutimet për përbërjen e qeverisë së re. Nënkryetarja Osmani foli për vazhdimin e takimeve të grupeve punuese të LDK-së me ato të LV-së për përpjekjet për përafrimin e programeve të dy partive drejt një programi të përbashkët qeverisës. Po të enjten nënkryetarja e LDK-së, Vjosa

Osmani, është takuar edhe me ambasadorin e Finlandës në Kosovë, Pia Stjernvall.

Gjatë takimit janë diskutuar për prioritetet kyçe të qeverisjes së ardhshme, në veçanti reformat në institucionet e Kosovës, zhvillimin ekonomik, arsimin dhe çështje të tjera të cilat ndikojnë në zhvillimin e Kosovës.



KEDS-i me 15 aktivitete shënon Javën Evropiane për Siguri dhe Shëndet në Punë

PRISHTINË, 24 TETOR (ER) - Kompania energjetike KEDS Javën Evropiane për Siguri dhe Shëndetësi në Punë e ka shënuar me 15 aktivitete përmes të cilave u dëshmuar se në këtë kompani punëtorët kanë siguri dhe shëndet në vendin e punës.

Disa prej këtyre aktiviteteve që i prezantuan punëtorët e KEDS-it janë pajisjet personale mbrojtëse, operimi në stabilitet i tensionit të mesëm dhe të ulët, përdorimi i indikatorit, ngritja e shtyllës së drurit, betonit, ngritja e trafo shtyllës, shkyçja dhe kyçja e njehsorit elektrik etj.

Drejtori ekzekutiv i KEDS-it, Aleper Elbas, ka deklaruar se siguria dhe shëndeti i punëtorëve është tejet i rëndësishëm andaj, sipas tij, me themelimin e Qendrës për Trajnime synojnë që

në vendin e punës të kenë zero për qind aksidente. "Siguria e shëndetit është tejet e rëndësishme sepse, siç e dini, kur filluam ta ndërtojmë këtë qendër të trajnimit e kishim vetëm një ëndërr, pra të kemi zero aksidente. Në dy vjetët e kaluar i kemi ulur aksidentet për 40 për qind, e cila nuk është e mjaftueshme për ne, por sa për fillim është mirë. Ne i trajnojmë të punësuarit vetëm për shëndet dhe perspektivë të sigurisë, 45 mijë orë e cila nuk është e mjaftueshme dhe po u them ekipeve t'i rrisin dhe nxjerrin udhëzimet", ka deklaruar ai.

Drejtoresha e burimeve njerëzore pranë KEDS-it, Valbona Kadrijaj, ka thënë se duke qenë se punëtoritë e KEDS-it veprojnë në një ambient me rrezikshmëri të lartë, kjo kompani ka marrë një sërë

masash për të ofruar ambient të sigurt në vendin e punës. Sipas saj, krahas shumë trajnimeve KEDS-i që nga viti 2018 ka hapur edhe qendrën e trajnimit përmes së cilës po ofrohen praktikat më të mira për sigurinë dhe shëndetin në punë. "Ne kemi avancuar tutje duke e ngritur nivelin e përgjegjësisë dhe si rrjedhojë në vitin 2018 kemi krijuar qendrën e trajnimit në të cilën jemi sot dhe nga nëntori 2018 në vazhdimësi organizohen trajnime në këtë qendër për nivele të ndryshme të përgjegjësisë për punonjës të divizioneve të ndryshme. Duke përdorur praktikat më të mira qëllimi ynë është që të zhvillojmë një sistem të menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë. Këtu janë të lidhur një sërë faktorësh që ne i kemi parasysh: vetëdijësimi i punë-

torëve për sigurinë në punë, mentorimi dhe monitorimi në vendin e punës që ne e bëjmë vazhdim, po ashtu sigurimi i pajisjeve personale mbrojtëse dhe veglave profesionale për punë, përmbushja ligjore për certifikim të punëtorëve etj", u shpreh ajo.

Ushtruesi i detyrës së kryeinspektorit të Inspektoratit të Punës, Valon Leci, ka deklaruar se Inspektorati i Punës ka punuar gjatë për vetëdijësimin e punëtorëve për shëndetin dhe sigurinë në punë. Sipas tij, s'është lajm i mirë që në këtë vit si pasojë e kontaktit me energji elektrike kanë gjetur vdekjen rreth pesë punëtorë dhe shpreson që përmes bashkëpunimit të ketë sa më pak aksidente në vendin e punës. "Fatkeqësisht, këtë vit kemi disa persona të cilët kanë humbur

jetën si pasojë e kontaktit me energjinë elektrike. Shpresoj që nga ky forum dhe nga kjo javë që ka të bëjë me sigurinë dhe shëndetin në punë të ngritët vetëdija e të gjitha palëve që të ruhen. Kemi katër apo pesë persona që kanë humbur jetën si pasojë e kontaktit me energjinë elektrike. Ky nuk është lajm i mirë. Shpresojmë që bashkërisht secili në segmentin që e mbulojmë në vitet e ardhshme të ketë minimalisht aksidente në vendin e punës", u shpreh Leci.

Në emër të organizatës "Kosha", Fatmir Saraçinu në këtë ceremoni ndau mirënjohje për bashkëpunim për drejtorin e KEDS-it, Alper Elbas.

Qendra e Trajnimit të KEDS-it është hapur në vitin 2018 dhe merret me trajnimin e punëtorëve të kësaj kompanie.



Kosova, e 57-a në raportin e 'Të bërit biznes'

PRISHTINË, 24 TETOR - Banka Botërore ka publikuar raportin "Të bërit biznes" për vitin 2020, i cili përfshin 190 ekonomitë në gjithë botën. Raporti ka vlerësuar zbatimin e gati 300 reformave në periudhën maj 2018 - maj 2019. Kosova në këtë raport renditet e 57-a. Në të, mes të tjerash, është thënë se Kosova e ka bërë më të lehtë menaxhimin e lejeve të ndër-

timit, ka përmirësuar furnizimin me energji elektrike, ka forcuar mbrojtjen e investitorëve të pakicave dhe ka lehtësuar zbatimin e kontratave.

Lista e Bankës Botërore kryesohet nga Zelanda e Re, ndërsa pas saj vijnë Singapori dhe Hong Kongu. Në fund të listës janë Somalia, Eritrea dhe Venezuela.

Raporti thekson se ekonomitë me përmirësimin më të dukshëm në "Të bërit biznes" janë Arabia Saudite, Jordania, Togo, Bahrejni, Taxhikistani, Pakistani, Kuvajti, Kina, India dhe Nigeria.

Në periudhën 2018-'19 këto vende kanë zbatuar një të pestën e të gjitha reformave të regjistruara në të gjithë botën, është thënë në raport.



15.5 milionë euro kursime nëse qeveria e re zvogëlon postet ministrore

Instituti GAP ka vlerësuar se me zvogëlimin e qeverisë, sipas premtimeve zgjedhore të Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), të cilat pritet të lidhin koalicion qeverisës, buxhetit të Kosovës do t'i kursehen rreth 15.5 milionë euro për një mandat qeverisës

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 24 TETOR - Me zvogëlimin e qeverisë, sipas premtimeve zgjedhore të partive politike, Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), të cilat pritet të lidhin koalicion qeverisës, buxhetit të Kosovës do t'i kursehen rreth 15.5 milionë euro për një mandat qeverisës. "Sipas udhëzimeve administrative 04/2008 dhe 01/2008 zëvendëskryeministrat, ministrat, zëvendësministrat, këshilltarët politikë dhe shefat e kabineteve përveç pagës mujore gëzojnë edhe përfitime të tjera shtesë, ku u mbulohet një shumë e caktuar për shpenzimet e drekave dhe telefonit (mobil dhe fiks). Nga shkurtimi i pozitive të paraqitura në infografikë, shpenzimet për ushqim, karburante dhe telefoni do të reduktoheshin automatikisht për rreth 3.4 milionë euro në një mandat", është thënë në komunikatën e Institutit GAP. Sipas këtij instituti, bazuar në pre-

timet elektorale, numri i zëvendëskryeministrave pritet të ulet nga 5 në 2. "Ndërsa nga shkurtimi i posteve ministrore nga 21 në 12, bazuar në premtimet e dy partive, zvogëlohet edhe numri i zëvendësministrave dhe këshilltarëve politikë. LV-ja dhe LDK-ja kanë premtuar se do të emërojnë jo më shumë se dy zëvendësministra për ministri, që i bie nga 80+ sa kanë qenë në qeverinë e kaluar, të mbeten maksimum 24 zëvendësministra", theksohet në këtë komunikatë.

Sipas Institutit GAP, me vetëm 12 ministri numri i këshilltarëve për ministër/re, sipas rregullores në fuqi, do të jetë maksimum 7, duke përfshirë këtu edhe këshilltarin/en e lartë të ministrit/es. "Ngjashëm është premtuar që në qeverinë e ardhshme numri i këshilltarëve të kryeministrit/es do të jetë 5 mirëpo, për shkak që baza ligjore e plotësuar gjatë mandatit të kaluar lejon që kryeministri/ja të emërojë edhe këshilltarë nga nëntë komunitete në Kosovë, numri total i tyre

pritet të mos kalojë 10", është theksuar në komunikatën e GAP-it.

Instituti GAP ka theksuar se LV-ja dhe LDK-ja kanë premtuar se do të shuhen pozitat e koordinatorëve nacionalë, ku në qeverinë e kaluar ishin katër pozita të tilla me pagë të ngjashme si ajo e postit të ministrave. "Ngjashëm pritet që numri i këshilltarëve të zëvendëskryeministrave të mos jetë më i lartë se i atyre të kryeministrit/es dhe që mund të ndodhë që zëvendëskryeministrat të mbajnë dhe poste ministrore, me gjithsej 12 këshilltarë të tillë. Duke marrë të gjitha këto për bazë, Instituti GAP vlerëson se në një mandat të plotë do të kursehen së paku 15.5 milionë euro në paga dhe shpenzime të tjera që ndërlidhen me postet politike në qeveri. Përveç kursimeve, një qeveri më e vogël rrit edhe efikasitetin e koordinimit, shkurton kohën e marrjes së vendimeve, rrit besimin e qytetarëve, si dhe krijon adresa të qarta të përgjegjësisë", është thënë në komunikatën e Institutit GAP.

15.5 milionë euro kursime

në një mandat qeverisës nëse qeveria mban premtimin për zvogëlimin e posteve ministrore

| Postet | Qeveria PAN | Premtimet VV+LDK |
|---------------------------------------|-------------|------------------|
| Zëvendëskryeministrat | 5 | 2 |
| Ministritë | 21 | 12 |
| Zëvendësministrat | 80+ | 24 |
| Këshilltarë të Kryeministrit/es | 24 | 10 |
| Këshilltarë të zëvendëskryeministrave | 43 | 12 |
| Këshilltar të lartë të ministrave/eve | 21 | 12 |
| Këshilltarë të ministrit/es | 126 | 72 |
| Koordinatorë nacional | 4 | 0 |

Kursime për një mandat 4 vjeçar

| | |
|----------------|-------------|
| Paga | 12,104,933€ |
| Ushqim | 1,392,000€ |
| Telefona mobil | 910,080€ |
| Karburante | 607,200€ |
| Telefona fiks | 492,000€ |

Malisheva, aksion për qytet të pastër

Malishevë, 24 tetor (ER) - Drejtorja e Inspektoratit e Mjedisit dhe Kompania "Ekoregjioni" në Malishevë kanë ndërmarrë një aksion të përbashkët me moton "Për një qytet të pastër". Aksionit i janë përgjigjur punëtorët e kompanisë "Ekoregjioni". Pjesë

aktive e aksionit ishin edhe inspektorët e mjedisit. Pastrimi "Për një qytet të pastër" ka nisur nga qendra e qytetit dhe ka vazhduar pranë lumit "Mirusha" e deri në lagjen "Mirëdita". "Ky aksion do të jetë i herëpashershëm dhe qëllimi është që të ngritët vetëdijesimi

qytetar, institucional, por edhe shoqëror, që të punojmë për një ambient të pastër. Ambienti i pastër është shëndeti i fëmijëve tanë. Me këtë aktivitet dhe porosi jemi obligues para zbatueshmërisë ligjore për mbrojtje të mjedisit", ka njoftuar Komuna e Malishevës.



Haziri dhe drejtori i Arsimit nga Bursa shtojnë bashkëpunimin

GJILAN, 24 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka pritur në takim punë një delegacion të drejtorëve të shkollave në Bursa të Turqisë, në krye me drejtorin e Arsimit, Gurhan Çokgezer.

Haziri pasi ka falënderuar delegacionin turk për vizitën në Gjilan ka thënë se është rast i mirë që pas binjakëzimit të shkollave të kalojnë në nivel të fëmijëve e nxënësve e studentëve në mënyrë që t'i marrin përvojat e arsimit në Republikën e Turqisë. "E falënderoj shumë drejtorin e Arsimit në Bursa, Gurhan Çokgezer, për një përkushtim që shkollat e Gjilanit të binjakëzohen dhe të zhvillohen. Po ashtu, edhe drejtorët e shkollave tona i falënderoj për punën, angazhimin dhe organizimin. Drejtori Gagica ka qenë një prej njerëzve kryesor që ka ndikuar në këtë bashkëpunim.

Tash e tutje do të kalojmë në nivel të fëmijëve e nxënësve e studentëve në mënyrë që t'i marrin përvojat e arsimit në Republikën e Turqisë", ka thënë Haziri.

Ndërsa drejtori i Arsimit në Bursa, Gurhan Çokgezer, ka falënderuar kryetarin Haziri dhe përfaqësuesit e arsimit në Gjilan për pritjen e jashtëzakonshme që i kanë bërë dhe për ofrimin e bashkëpunimit. "Është hera e pestë që po vijmë në Gjilan dhe së bashku jemi me tetë drejtorë të shkollave të binjakëzuara me tetë shkollat këtu. Dituria arrihet duke u shpërndarë dhe ne do t'i marrim përvojat dhe dituritë tuaja për t'i implementuar edhe në Turqi. Shpresoj në ditë më të mira për të dy shtetet", ka deklaruar Çokgezeri.

Në këtë takim ka marrë pjesë edhe kryetari i shoqatës Kosova-Shkup, Rexhep Gunduz.



Disa fermerë të Dragashit mbështeten me grante për kultivimin e pemëve të imta



Fermerë nga Dragashi kanë pranuar materialet thelbësore si fidanë, sisteme të ujitjes, shtylla betoni, rrethoja, plehra dhe preparate mbrojtëse, duke ua mundësuar atyre kultivimin e varieteteve "Senga Sengana" të dredhëzës, "Willamette" të mjedrës

DRAGASH, 24 TETOR (ER) - Caritasi zviceran së bashku me Komunën e Dragashit kanë mbështetur tre fermerë përfitues me paketa granti për kultivimin e mjedrës, dredhëzës dhe boronicës. Këta fermerë nga Dragashi kanë pranuar materialet thelbësore si fidanë, sisteme të ujitjes, shtylla betoni, rrethoja, plehra dhe preparate mbrojtëse, duke ua mundësuar atyre kultivimin e varieteteve "Senga Sengana" të dredhëzës, "Willamette" të mjedrës dhe "Duke" të boronicës, në për-

puthje me standardet e kërkuara për prodhimtarinë bujqësore. Me këtë rast, fermerët kanë falënderuar Caritasin zviceran dhe Komunën e Dragashit për shpërndarjen e pakove të kompletuara të përbëra nga të gjitha materialet e nevojshme për kultivim, trajtim dhe korrije të këtyre produkteve bujqësore. Paketat e granteve mbulohen 50 për qind nga Caritasi zviceran, 35 për qind nga Komuna e Dragashit dhe 15 për qind nga vetë fermerët.

Nis asfaltimi i rrugës Jashanicë-Ujmirë në Klinë

Klinë, 24 tetor (ER) - Kryetari i Komunës së Klinës, Zenun Elezaj, ka inspektuar nga afër fillimin e shtrimit të shtresës së asfaltit në rrugën Jashanicë

- Ujmirë. Me këtë rast, kryetari Elezaj ka thënë se janë duke u angazhuar që me projekte të tilla t'ua lehtësojnë jetën qytetarëve duke u mundësuar

atyre një qarkullim më të lehtë. Të enjten Elezaj ka parë nga afër edhe shtrimin e shtresës së asfaltit në disa rrugë të tjera lokale në qytet.

Komuna e Klinës është duke vazhduar realizimin e projekteve që kanë për qëllim përmirësimin e infrastrukturës rrugore.



Vite të humbura, pas 14 vjetëve të Edi Ramës si 'lider i së majtës'



Nga Bedri ISLAMI

14 vjet më parë, kur socialistët, pas dorëheqjes së liderit të tyre, Nano, i cili iku pas zgjedhjeve të humbura të vitit 2005, do ta zgjidhnin drejtuesin e ri dhe, si dihet, në garë ishin Meidani dhe Rama, një njeri i mençur, duke folur me disa nga drejtuesit e njohur, u tha se do të bënin mirë ta zgjidhnin të parin. Kur ata e kundërshtuan, miku i tyre shtoi se "Meidani, po të doni, e largoni pas dy vjetëve, ndërsa Edi Ramën, edhe po të doni, nuk e largoni më, në të kundërtën, do t'ju heqë ai juve".

U bënë 14 vjet që nga ajo kohë. Disa nga figurat themeluese nuk janë më aty, në elitën drejtuese të së majtës, u larguan nga mosha, nga dëshira e tyre apo nga nënvlerësimi, kjo është diçka tjetër, por fakti është se nuk janë më. Por, kjo nuk është thelbësore.

Koha ka ardhur, pas 14 vjetëve lideri i së majtës, çfarë risie ka sjellë; është moderuar më tej e majta apo është mbyllur ajo në një rreth të ngushtë; është krijesa Rilindja një elitë e së majtës apo një sekt politik që i ka hipur asaj në qafë dhe që, bashkë me oligarkët financiarë, kanë krijuar një gjendje të re politike; është hapur ajo, e majta, për të rinjtë që aspirojnë një Shqipëri ndryshe apo, pas vrullit dhe besimit të parë, portat janë mbyllur dhe dritëzimi që kishin parë nuk është më; ka në të majtën shqiptare diçka nga tradita e saj apo nga e majta evropiane apo është kthyer në një amalgamë bindjesh dhe heshtjesh të pafundme, që nuk kanë të bëjnë me asnjë rrymë politike; ku është pjesa e mendimit intelektual apo gjithçka është kthyer në një memeceri të heshtur; deputetët e saj janë vërtet ata që duhet të jenë apo është bërë një grumbullim pazareh dhe votash, të cilat shumë diktohen nga forca sesa nga mendja?

Në fund të fundit, kemi të bëjmë me një periudhë 14-vjeçare të rritjes së mendimit apo ishin, edhe një herë, vite të humbura apo gjysmë të humbura.

Tetë vjet në opozitë dhe, pothuaj, kaq në pushtet, kanë krijuar dy figura lideri në një të vetëm: fillesën e një reformatori dhe kthimin e një diktati. Kur Rama, pas zgjedhjes së tij në kreun e PS-së, më shumë nga bijtë dhe bijat që detyruan etërit të votonin për të, deklaroi se mbaruan seriallet e famshme të KPD-së, shumë nga e majta u ndien të lehtësuar pasi, si kudo, jo e gjitha ishte e qartë, e duhur dhe e domosdoshme. Por askush nuk e diti e as

nuk e mori me mend se, pas "mbylljes" së serialeve politike do të binte heshtja e detyruar politike, mbyllja e mendimit dhe vizionit, çka ishte po aq e rëndë, në mos më e rëndë sesa mbyllja.

Diktati i Njëshit po bëhet po aq i rëndë sa në PD-në e Berishës. Forca e Njëshit po bëhet po aq asfiksuese për mendimin ndryshe. Mjaftoi një fillesë kundërshtimi nga ish-ministri i Jashtëm, Bushati dhe ai u gjet jashtë kabinetit qeveritar, por edhe më përtej saj. Nga të gjithë ish-ministrat, megjithëse më pak i përfolur, ai do të jetë i vetmi që nuk do të ketë as postin partiak, si drejtues i së majtës në Shkodër dhe, në vendin e tij, pa mëdyshje dhe pa i thënë asnjë strukture, Rama vendosi një delikuent, të cilin, deri atë kohe nuk e njihje askush dhe, mjerisht, dihet se çfarë doli prej tij.

Nga ideja e mendimit kolegial, jo menjëherë, por sidomos pas ndryshimeve kobzeza 2008, u rrit në përmasa të frikshme roli i liderit dhe të gjithë strukturat e tjera heshtën. Tani asgjë nuk ka më rëndësi para mendimit të tij, i cili, edhe sikur të ishte dhjetë herë më i mençur dhe më i ditur, përsëri do ta kishte pasur nevojën e një mendimi ndryshe, të cilin, dikur kishte paralajmëruar se, edhe nëse nuk do e kishte në parti, do e nxiste të ishte.

Në natën, do të thosha, tejet të hidhur, kur në Bashkimin Evropian do të vendosej e ardhmja e afërt e Shqipërisë, mendimi politik e qeverisës ishte diku tjetër. Ata, si pa të keq, pa ia ndërë se çfarë ndodh në Bruksel, kaluan një ligj të llahtarshëm, Krijimin e Korporatës Shqiptare për Investime, si oktapod oligark, i lejuar nga shteti, për ta rrjepur shtetin dhe vetë njerëzit. Një drejtues i së majtës që ndan pasurinë kombëtare, si të ishte malli i tij nga Surreli, gjithçka mund të jetë, por me kombin dhe popullin që i ka rënë rasti e shansi të drejtë, ka pak lidhje. Duke i detyruar 77 deputetë mjeranë, që janë lista e tij dhe që refuzimi do të thotë dërmim, ta ngrenë dorën, ai krijoi një superfuqi, edhe mbi shtetin, ku nesër, kur të mos jetë kryeministër, ai mund të jetë bartësi i aksioneve të mëdha dhe kapoja i zotërimit të shtetit. Mungesa e Gjykatës Kushtetuese, që e shembi kur nuk duhej shembur dhe nuk po e ngre kur duhet ngritur, i jep gjithçkaje tablonë e një ngarendje pas vetes dhe në dëm të vendit.

Ende pa u ndërmarrë vendimi përfundimtar dhe kur vëmendja është përqendruar se çka thotë presidenti francez, njerëzit mësojnë se qeveria i ka dhënë një firmë, gjysmamerikane, drejtuesi i së cilës është i njohur për lidhjet me zotin Meta dhe Berisha, koncesionin e Butrintit, perlës së njohur së arkeologjisë të kulturës shqiptare, e cila

vetëm nga shitja e biletave përfiton deri në një milion euro në vit. Pastaj vjen lajmi tjetër, koncesioni për Kepin e Rodonit, po ashtu një zonë historike. Për 35 vjet. Do të thotë, përjetësisht. Askush në PS, në stafin e lartë drejtues të saj nuk thotë gjë. Pushteti qëndron mbi partinë dhe ia merr frymën së majtës. Deklarimet e Ballës ta marrin frymën edhe nga cektësia, ndërsa të Spiropalit të ngjallin të qeshurën. Ministrat dolën nga xhepi i majtë i shefit dhe iu servirën një plateje të heshtur që, si për të dashur të dëshmonte se kishte heshtur nga halli e frika, duartrokitën vetëm një zgjedhje, Erion Braçen. Po të varfrit që u shtuan, po klasa e mesme që po ikën, po të rinjtë e zhgënjyer? Në gjashtë vjet qeverisje nuk është dhënë thujse asnjëherë rroga e trembëdhjetë, e shumëpritur nga nëpunësit dhe punëtorët, por u janë falur oligarkëve qindra milionë euro; u janë shtrenguar vidhat atyre që nuk kanë mundësi të paguajnë dhe asnjë subvencion nuk shkon drejt tyre, por tenderët dhe PPP-të vrastare kanë kosto të pamatë. Vetëm gjysma e këtyre abuzimeve nga PPP-të ishin të favor të njerëzve të zakonshëm, do të kishte edhe pagesa në muajin e pushimeve, që është harruar, edhe rrogë të 13-të, edhe shpërblimi i fundvitit për pensionistët, edhe libra, vërtet falas për fëmijët.

I nisur nga e majta, për të ndërtuar një shoqëri dhe shtet për njerëzit, po kthehet në një shoqëri edhe më tej të polarizuar dhe shtet të oligarkëve.

Kisha menduar me dëshirë të madhe se, sido kudo, nga një njeri i lexuar, që drejtoi bashkinë kryeqytetase me një dorë të hekurt dhe të frytshme gjërat do të ishin ndryshe, aq më shumë duke njohur kapacitetet intelektuale që ishin në të majtën.

Viti 2009 ishte fillimi i shkatërrimit të kësaj strukture, ndërsa viti 2013 i dha fund atij.

Të shohësh kur del për të folur një deputet a deputete dhe të mos e

dish se kush është, edhe pas gjashtë viteve parlamentllëk, të mos dish se kush është ministre e kulturës, financës, se cili është roli i ministrit të jashtëm në detyrë, pse ministri i brendshëm, nga njeriu i thjeshtë i shkon shpesh herë delirantit, të të duket ministrja Besa e Arsimit më e mira dhe më e denja, duke e krahasuar me rreth e rrotull; të përpiqesh të glesh se çfarë e pengon ministren e drejtësisë, që edhe pse bën një punë të mirë, nuk i çon gjërat deri në fund; të lodhesh për të ditur e nuk e di kurrë, përse Vetingu nuk filloi nga figurat e përfolura të sistemit të drejtësisë, të cilët dihej se kush ishin, duke lënë në punë disa struktura të jashtëzakonshme; përse, edhe pas kaq kohësh nuk ka asnjë nismë serioze për SPAK etj, të gjitha bashkë nuk janë asgjë ballë rolit të oligarkisë financiare dhe politike, të cilat, në tri vitet e fundit, janë bërë një palë që, që po tërheqin karron e vetvetes.

E majta do të kishte fituar në vitin 2013 edhe sikur lideri i saj të mos ishte Edi Rama, megjithëse paraqitja e saj ishte nën figurën e tij politike, që dukej vizionare, e kohës dhe e së ardhmes. Drejtimi i së majtës nga Rama solli më shumë vota, duhet saktësuar, por ndëshkimi ndaj qeverisjes Berisha, që ishte bërë sinonim i vjedhjes, vrasjes dhe shijes, do të ndodhte. Kam pasur rastin të kem në duar ose të njoh, qoftë edhe përmes mediave, të dhëna të ofruara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, institucioni më serioz dhe më i besuar i shtetit, edhe nga struktura të rëndësishme evropiane. Shifrat e paraqitura janë lehtëtëse. Thuaj se çdo javë në 7 vitet e fundit, apo, mesatarisht çdo javë, është dërguar një dosje për ndjekje penale në sistemin e drejtësisë dhe është informuar struktura e lartë drejtuese e shtetit.

Edhe njerëzit e zakonshëm, e majta e lodhur nga keqqeverisja Berisha dhe zullumet e Lul Bashës, ka pritur ndëshkimin, që në fakt

do të thotë mbyllja e së keqes.

Oratoria joshëse e Ramës, në dy fushatat për ndëshkimin e së keqes përfundoi duke e bërë të keqen pjesë të vetes dhe natyrshëm politike.

PPP-ja e famshme për autostradën Milot - Balldre, ka një çmim të pamatë, dhe kjo sepse është e lidhur me oligarkë afër shefit të qeverisë. Me të njëjtën shumë të afruar nga qeveria, një firmë tjetër ndërtimi, me përvojë, afron ofertën e saj që, kjo autostradë, të shkojë deri në Hanin e Hotit, por askush nuk e dëgjon. Çuditërisht autostrada mbyllet në fillimin e rrugës Lezhë-Shkodër, duke e lënë përsëri njëkalimëshe, çka e penalizon gjithë lëvizjen drejt Veriut.

Politikanët e pandëshkuar, premtim politik dhe mendësi e së majtës, si një domosdoshmëri për të kthyer vëmendjen drejt njerëzve është harruar prej kohësh, krimi i 21 janarit është shpërblyer në të holla. Gërdeci është amnistuar. Ata që hapën greminë financiare të vitit 2013 dhe predikuan theqafjen e vendit, janë shpërblyer, thjeshtë nga lidhjet që kanë pasur me të njëjtët oligarkë që ka edhe shefi i qeverisë. Po, ata, të majtët, shpresëhumbur nga Berisha dhe tani bjerrahumbës nga Rama?

E majta në Shqipëri ka humbur liderin e saj dhe, si duket, nuk do të ketë forcë për ta rigjetur ose për ta rikthyer Ramën në mendimin politik dhe sjelljen politike të para vitit 2013, atëherë kur ua kishte nevojën atyre.

Fati i madh i tij është një opozitë laramane, pa vizion, pa ide, pa lider, që qahet edhe kur i ftohet supa dhe që doli në rrugë për të humbur gjithçka.

Por, nuk është fati i së majtës që në secilën ditë humb nga identiteti i saj dhe e sheh pa besim ringritje se si, pa pasur asnjë të keqe nga jashtë, krimbi i politikës po e bren nga brenda.

Rizgimi do të jetë i vonshëm dhe me dhimbje.



Stoltenberg: Kohë të vështira për kontrollin e armëve

BRUKSEL, 24 TETOR - Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, tha se regjimet e kontrollit të armëve duhet të përshtaten me realitetet e reja për të mbetur efektive. "Këto janë kohë të vështira për kontrollin e armëve", tha Stoltenbergu në një konferencë të NATO-s në Bruksel, në lidhje me këtë çështje. "Regjimi global i kontrollit të armëve që na ka shërbyer aq mirë po shkatërrohet", tha Stoltenbergu. Ai theksoi se aleanca ushtarake

perëndimore është e përkushtuar për kontrollin e armëve, çarçatimin dhe mospërhapjen bërthamore.

Konferenca vjen disa muaj pasi Uashingtoni është tërhequr nga Traktati për Armë Bërthamore, pas akuzave që i ka bërë Moskës për zhvillim të armëve në kundërshtim me këtë marrëveshje, që daton nga periudha e Luftës së Ftohtë.

Moska më vonë veproi njëjtë dhe u tërhoq nga Traktati. Stoltenbergu akuzoi edhe

Korenë Veriore e Iranin për "injoin apo shkelje të rregullave globale si dhe shpërndarje të teknologjisë së rrezikshme dhe raketave në gjithë botën".

Stoltenbergu shtoi se rritja e Kinës ndikon në regjimin aktual të kontrollit të armëve, pasi ky shtet aktualisht ka buxhetin e dytë më të madh në botë për mbrojtje pas Shteteve të Bashkuara.

NATO-ja duhet "të jetë e bashkuar dhe të reflektojë mbi këto realitete", tha Stoltenbergu.



Trumpi përpiqet t'i diskreditojë hetimet e Dhomës së Përfaqësuesve

Duke u përpjekur t'i diskreditojë hetimet e Dhomës së Përfaqësuesve, presidenti Trump në fjalimin e vet mbajtur të mërkurën në Pensilvani tha se ata nuk na mposhtën dot në kutinë e votimit, prandaj përpiqen të na mposhtin me mënyrën e vjetër, që nuk është shumë e hijshme

UASHINGTON, 24 TETOR - Presidenti Donald Trump dhe përkrahësit e tij në Kongres po kërkojnë t'i minojnë përpjekjet e drejtuara nga demokratët për të mbledhur dëshmi që do të çonin në ngritjen e një padie për shkarkimin e presidentit. Presidenti Trump i quajti hetimet thjesht një gjueti

shtrigash kundër tij, ndërkohë që republikanët e kanë cilësuar procesin hetimor si të fshehtë dhe jodemokratik. Kritikët thonë se këto përpjekje të republikanëve synojnë ta heqin vëmendjen nga disa dëshmi të dhëna ditët e fundit në Kongres që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e adminis-

tratës me Ukrainën dhe që e dëmtojnë presidentin.

Në një fjalim të mërkurën në Pensilvani, presidenti lavdëroi politikën e tij për energjinë dhe rritjen ekonomike të vendit, por e preku çështjen e hetimit shkarazi, si pjesë e një kritike të përgjithshme kundër demokratëve. "Ata nuk na mposhtin dot në kutinë e votimit, prandaj përpiqen të na mposhtin me mënyrën e vjetër, që nuk është shumë e hijshme. Ata janë një grup njerëzish të këqij", tha presidenti, ka njoftuar voa.

Komentet erdhën disa orë pas një

mëngjesi të trazuar në Kapitol, ku një grup ligjvënësish republikanë u përpoqën të hyjnë me forcë në sallën e Komisionit të Inteligjencës, ku po zhvillohej një dëshmi me dyer të mbyllura. Ligjvënësit nuk ishin anëtarë të komisioneve të kongresit që po zhvillonin hetimin dhe nuk kishin të drejtë të hynin, por ata argumentuan se çështja ishte tepër e rëndësishme dhe hetimet nuk mund të bëheshin me dyer të mbyllura. "Ne po përpiqemi të kemi transparencë në këtë proces. Unë përfaqësoj afro një milion banorë të Floridës që më

kërkojnë mendimet e mia për këtë proces. E megjithatë nuk mund t'u them atyre asgjë, përveç asaj që u është dhënë medieve", tha republikani Mike Waltz.

Për shkak të kësaj ngjarjeje, dëshmia e planifikuar u shty për disa orë.

Kritikët thonë se rrëmuja u krijua për të hequr vëmendjen e publikut nga dëmi që shkaktoi dëshmia e dhënë para ligjvënësve të martën nga ish-ambasadori amerikan në Ukrainë Bill Taylor. Diplomati shumë i respektuar, i përzgjedhur në këtë post nga vetë Sekretari i Shtetit Mike Pompeo, konfirmoi pohimin e një informatori se presidenti Trump e kushtëzoi ndihmën amerikane për Ukrainën me gatishmërinë e saj për të bashkëpunuar në përpjekjet për të dëmtuar rivalin politik të Trumpit. "Në këta dhjetë muaj që kam në Kongres, kjo është dita ime më e shqetësuar deri më tani", tha demokrati Andy Levin.

Dëshmia e gjatë e Taylorit i bëri të heshtin përkohësisht edhe disa prej anëtarëve të partisë së vetë presidentit Trump. Kjo shkaktoi zemërimin e presidentit, i cili u shpreh me një koment në Twitter se republikanët që nuk e mbështesin atë janë më të këqij sesa demokratët. Të mërkurën, një gjyqtar federal urdhëroi Departamentin e Shtetit t'i zhblllokojë dokumentet që lidhen me Ukrainën, duke përfshirë komunikimet midis Sekretarit Pompeo dhe avokatit personal të presidentit Trump, Rudy Giuliani.



Gantz tenton të formojë koalicion qeverisës në Izrael

TEL AVIV, 24 TETOR - Udhëheqësi i partisë Bardhë e Blu të Izraelit, Benny Gantz, do të tentojë të formojë një koalicion qeverisës pas dështimit të kryeministri Benjamin Netanyahu. Presidenti izraelit Reuven Rivlin i ka ofruar zyrtarisht partisë centriste Bardhë e Blu mundësinë e krijimit të një koalicioni që për të qeverisur

do t'i duhet një shumicë prej 61 vendesh në Parlamentin izraelit.

Benny Gantz ka 28 ditë në dispozicion për të arritur një marrëveshje për të qeverisur. Nëse ai dështon, atëherë të gjitha partitë parlamentare do t'u jepet një mundësi të formojnë qeverinë. Nëse edhe kjo nuk ndodh atëherë vendi do të

shkojë në zgjedhje të parakohshme, çka do të shënonte herën e tretë brenda këtij viti, me shpresën për t'i dhënë fund ngërçit politik.

Në zgjedhjet e muajit shtatorit, partia Likud e Benjamin Netanyahu fitoi 32 vende të parlamentit prej 120 anëtarësh, ndërsa ajo Bardh e Blu Benny Gantz, 33.





AMBASADORI GASHI NË PARIS, PRET BIZNESET NGA KOSOVA

Ambasadori i Republikës së Kosovës në Paris, Prof. dr. Qëndrim Gashi, priti një delegacion të firmave private partnere të Knauf Insulation nga Kosova në krye me drejtorin e Knauf Kosova dhe

Albania, Prof. Dr. Sylejman Berisha!
Ambasadori z. Gashi rezervoi një takim të veçantë dhe ofroi një mikëpritje të ngrohtë e miqësore!
Ambasadori z. Gashi i njoftoi

për mbarëvajtjen e angazhimeve të Ambasadës së Kosovës në Paris!
Gjithashtu i njoftoi për shumë ngjarje të rëndësishme të Francës në përgjithësi e të Parisit në veçanti!

Në pritje të Ambasadori i Kosovës në Paris, ishin edhe pronarët e firmave "Vatani" z. Ismet Sylejmani, "Annex" Mehmet Hoxha, "Ok" Hasan Bytyqi dhe "Real Color" Alban Pajaziti!

Në fund ambasadori z. Gashi i falenderoi për viziten dhe ju ofroi mikëpritje në çdo kohë e kurdoherë ta vizitoni Parisin!

Prof. Dr. Sylejman Berisha
Paris, 21 Tetor 2019!

Shijo Pranverën me...

Jaffa Champion PLUS
A+C+E Multifrutti

Taste of World Wide Brand!

2L

Jaffa Champion

E jashtëzakonshme

Kapet peshkaqeni 'tigër' 500 kilogramësh në Durrës

Një peshkaqen është kapur në ujërat e detit Adriatik nga peshkatarët durrsakë. Ka qenë peshkarexha "Meduza" që e ka nxjerrë në breg peshkaqenin që, sipas peshkatarëve, është i llojit tigër. Ai ka rënë në rrjetat e peshkatarëve në një thellësi prej 170 metrash dhe peshon afërsisht 500 kilogramë. Rastet e kapjes së peshkaqenëve në Adriatik janë shpeshtuar në vitet e fundit.



FOTO E DITES



Një djalë ecën në det, i mbuluar nga vaji i derdhur në plazhin Itapuama që ndodhet në qytetin Cabo de Santo në Brazil. /AFP/

E rrallë

Shteti që shpërblen familjet me 10 mijë euro për lindjen e çdo fëmije

Për ta zgjidhur problemin e rënies së popullsisë, një komunë e vogël në Finlandë ndërmori një hap të madh. Do t'i paguajë qytetarët e vet për çdo fëmijë. Lestijarvi është një komunë e vogël rurale në Finlandë e cila, si shumë zona të tjera, po përballlet me zvogëlimin e popullsisë. "Gjithmonë u kemi kushtuar vëmendje



lindjeve dhe kur mësuam se kishte vetëm një lindje vitin e kaluar u shqetësuam. Me pakësimin e fëmijëve nuk do të kemi më shkollë, kopshte", thotë kryetari i bashkisë, Esko Ahonen. Rreth 60 familje morën 10 mijë euro për 10 vjet. Duket shumë bujare, por janë masa të domosdoshme.

BARSOLETA E DITËS



- Grua, sot isha te mjeku. Ma fotografuan kokën por, sipas specializantëve, nuk gjetën asgjë!, - i tregoi burri gruas.
- Këtë e dija që sa kohë!, - ia bëri me dije ajo.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjatë vikendit në ora

14:00

ABOMINABLE 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 32 min

Rolet: Chloe Bennet, Tenzing Norgay Trainor, Albert Tsai, Eddie Izzard, Sarah Paulson, Tsai Chin, Michelle Wong, etj.
Regjia: Jill Culton



Çdo ditë në ora 16:00

TOY STORY 4 / 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 40 min

Rolet: Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.
Regjia: Josh Cooley



Çdo ditë në ora 18:00 dhe 20:00

MALEFICENT MISTRESS OF EVIL 3D

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 orë 58 min

Rolet: Angelina Jolie, Elle Fanning, Chiwetel Ejiofor, Sam Riley, Ed Skrein, Imelda Staunton, Juno Temple, Michelle Pfeiffer, etj.
Regjia: Joachim Ronning



Çdo ditë në ora 22:00

ZOMBIELAND DOUBLE TAP

Aksion/Komedi/Horror; 1 orë 39 min

Rolet: Woody Harrelson, Jesse Eisenberg, Emma Stone, Abigail Breslin, Rosario Dawson, Zoey Deutch, Luke Wilson, etj.

Regjia: Ruben Fleischer



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

| | | | | | |
|--|--|--|---|---|---|
|  <p>DASHI Vendimet që do të merrni sot do të jenë të drejta dhe të sinqerta.</p> |  <p>DEMI Çdo ditë lindin gjëra të reja dhe këtë do ta vërtetoni sot.</p> |  <p>BINJAKËT Veprimet tuaja sot do të jenë të mirëmbledhura dhe efektive.</p> |  <p>GAFORRJA Kjo do të jetë një ditë plot me të qeshura.</p> |  <p>LUANI Ndani mendimet tuaja me persona që mund t'ju japin këshilla.</p> |  <p>VIRGJËRESHA Përpikuni të mos i shihni gjërat me hollësi sot. Shijoni çdo gjë që ju ofrohet.</p> |
|  <p>PESHORJA Ekziston një lloj energjie që do të sjellë ndryshim dramatik në jetën tuaj.</p> |  <p>AKREPI Mendja mund të jetë duke luajtur me ju, kështu që nuk është në interesat tuaja që t'u besoni instinkteve.</p> |  <p>SHIGJETARI Sot mund të jetë një nga ato rastet kur mund të thoni se çfarë doni për një situatë të caktuar.</p> |  <p>BRICJAPI Ju jeni të prirë të tërhiqeni nga gjërat e gjalla dhe emocionuese sot.</p> |  <p>UJORI Ju duhet të ndërmerri një veprim të madh sot për ta mbrojtur pozicionin tuaj.</p> |  <p>PESHQIT Sot mund të përfshihen në një nga ato situata në të cilat thoni një gjë dhe më pas detyroheni ta shmangni të vërtetën ose të gënjeni për ta mbrojtur veten.</p> |

Rita Ora nis xhirimet për filmin "Twist"



Rita Ora ka marrë një tjetër rol në ekranin e madh. Këngëtarja me famë shqiptare është fotografuar gjatë xhirimeve të versionit modern të "Oliver". 28-vjeçarja ishte e

veshur me një palë pantallona të shkurtra boksi. Ylli i muzikës u fotografua në rrugët e Londrës përkrah aktorit Rafferty Law. Rita do ta luajë rolin e Artful Dodger në "Twist".

Rihanna 'ribashkohet' me Drake



Rihanna dhe Drake, të cilët ishin në lidhje në vitin 2016, u ribashkuan në festën e ditëlindjes së reperit të hënë në zonën e Los Anxhelosit. "Rihanna u paraqit aty dhe qëndroi për disa orë. Ajo ishte

me dy femra dhe ishte në tavolinën e Drake", ka pohuar një burim për "E!News". "Ajo dhe Drake po flisnin bashkë dhe po qeshnin. Dukeshin sikur po argëtoheshin së bashku si miq", ka thënë burimi në fjalë.



Rikthehet Sharon Stone, 61-vjeçarja trondit rrjetin me fotot e fundit

Sharon Stone është një ndër aktoret më të famshme në botë. Filmi ikonë në të cilin u përjetësua në kinematografi është, pa dyshim, "Basic Instinct". Derisa ka folur për revistën "Allure", për të cilën ka pozuar me të brendshme, Sharon Stone ka thënë se ndihet më mirë tani se kur ishte

vajzë. "Më pëlqen trupi im. Kur isha më e re më thoshin gjithmonë për problemet që kisha me trupin", ka treguar aktorja e njohur. Lidhur me filmin e famshëm "Basic Instinct", Stone thotë se nëse do të luante në këto kohë nuk do ta bënte të njëjtin efekt, pasi tashmë lakuriqësia ka dalë sheshit.

Selena Gomez publikon këngën e re, thumbon Justin Bieberin



Selena Gomez vetëm sapo ka befasuar duke hedhur një këngë të re dhe videoklip të ri të titulluar "Look at her now". Për ta ndarë lajmin e veçantë dhe emocionues, 27-vjeçarja zgjodhi "Instagram"-in duke publikuar një pjesë të këngës së vet. Krahas

këngës ajo falënderoi fansat që i qëndruan pranë edhe në çaste të vështira. Përmes këngës Selena deklaroi se do ta gjejë sërish dashurinë, pasi e goditi Justin Bieberin me tekstin thumbues në videon bardhë e zi të "Lose You To Love Me".

SERBIA ÇON NË UNESCO EDHE BRUMËRAT, DOSJA E EPOSIT TË KRESHNIKËVE ENDE NË TIRANË



Zymer Neziri teksa prezantoi në Akademinë e Shkencave në Shqipëri 40 vite studime për Eposin e Kreshnikëve e lahutën, propozoi që ky instrument të futet në shkolla, pa lënë mënjanë njohjen në UNESCO.

"Katër dekada më parë, në Rugovë kishim tetë lahutarë që dinin mbi 10 mijë vargje. Sot, në krejt zonat e veriut, të shpërndara në pesë shtete të Ballkanit, kemi vetëm dy. Gjendja nuk po ndryshon për mirë, por mund të konsiderohet e mirë në krahasim me të tjerët që po mbeten pa epos", thotë Neziri.

Lahutarët janë drejt zhdukjes, madje as lahutarët si Isa Elezi nuk kanë mundur ta përçojnë këtë traditë në familje. "I kam 21 nipa e mbesa, po s'kam mund të ndikoj", pohon me keqardhje, ndërsa shton se teknologjia e emigrimi kanë bërë të vetën. Në Rugovë, për 350 vite, siç ai

rrëfen, lahuta ka qenë pjesë e pandashme e çdo familjeje.

"Për atë shtëpi që ndoshta nuk e ka pasur, thoshin se i zoti është qyqar", tregon Isa. "Nga Cikli i Kreshnikëve zotëroj 35 mijë vargje, as i shkruaj, as i kam shkruar kurrë".

Rustem Bajramit, lahutarit që ka ditur përmendësh afro 60 këngë, duket se i ka prirë fati me lahutën: nipi i tij premton ta mbajë gjallë traditën e trashëguar në katër breza.

"I bie lahutës edhe më bukur se unë", rrëfen 89-vjeçari.

Ende sot, në moshë të thyer, ky instrument muzikor i jep zemër, siç ka ndodhur për vite me radhë me luftëtarët para betejave.

"Kur këndoj në lahutë, s'ka kush më del përballë, veç lumit Zot që më ka falë. Kosova më njuh e më ka dëgjuar të këndoj në borë e shi edhe gjatë protestave", thotë Bajrami.

"Lahuta, Eposi, mbartin përpjekjet e jashtëzakonshme të këtij kombi për të mbijetuar", rrëfen Vesel Nikqi, kryetari i Ansambllit Folklorik Autokton "Rugova", që prej 70 vitesh përpiqet të mbajë gjallë trashëgiminë. "Lahuta duhet të mbetet e jona. Për historinë, vlerat që mbart".

Sipas Nikqit, këto pasuri të trashëgimisë sonë janë lënë pas dore e institucionet e Kosovës e

Shqipërisë s'po bëjnë mjaftueshëm që Eposi, lahuta e asetet e tjera të trashëgimisë, të njihen edhe në UNESCO.

"Kemi punuar që 28 asete të trashëgimisë sonë shpirtërore të njihen nga UNESCO, i kemi dorëzuar pranë Ministrisë së Kosovës, po kanë mbet aty. Ne kemi Shqipërinë që është pranuar në UNESCO, ndaj s'duhet prit më gjatë. Këngët, veshjet, ritet, instrumentet, rrezikojmë të na i marrin të tjerët. Serbët edhe brumin e kanë çuar, ndaj ne duhet të marrim masat", thotë Nikqi.

Shqipëria s'ka më justifikime, Kosova i ka dhënë bekimin që Dosja e Eposit të Kreshnikëve të

dorëzohet nga qeveria jonë, meqenëse nuk është ende anëtare e UNESCO-s. Mësojmë se dosja është ende në Tiranë, në pritje të ndryshimeve të fundit. Aktualisht, Zymer Neziri thotë se kemi ende 300 bartës të Eposit të cilët dinë mbi 100 mijë vargje.

"Kjo është një pasuri jo vetëm shqiptare, por edhe evropiane e botërore. Si pjesë e dosjes, ne duhet të dëshmojmë se këtë traditë e kemi të gjallë. Asnjë popull nuk ka mundësi të dëshmojë aq fuqishëm sa shqiptarët, që kanë mbijetuar më gjatë se eposet e kulturave të tjera", rrëfen Neziri.

/Anila Dedaj/Panorama/



Më shumë hithra në vjeshtë për një imunitet më të fortë në dimër

Hithra është një barishte shumë e pasur në vlera për trupin e njeriut.

Ajo është e pasur në fibër, kalcium, magnez, proteinë apo vitaminat A dhe B6.

Kjo barishte duhet konsumuar rregullisht sepse ndihmon në mirëmbajtjen e nivelit të sheqerit në gjak, pastron organizmin nga toksinat dhe forcon sistemin imunitar.

Hithra kombinohet mjaft mirë me brokolin, domatet dhe praktikisht çdo perime tjetër të stinës.

Hithra për imunitetin

Duke qenë se hithra është shumë e pasur me hekur, ajo duhet konsumuar nga njerëzit që kanë pamjaftueshmëri të këtij minerali dhe anemikët.

Megjithatë, hekuri luan një rol thelbësor tek sistemi imunitar, sidomos tek limfocitet që mundësojnë reagimin në kohë të organizmit ndaj një infeksioni të mundshëm.

Ekspertët thonë se në stinët e pranverës dhe vjeshtës, trupi ka nevojë të mëdha për ushqyes dhe

mbështetje me vitamina e minerale.

Për këtë arsye, ata këshillojnë konsum të vazhdueshëm të hithrës dhe barishteve të ngjashme në këto stinë.

Hithra fuqizon mëlçinë, veshkat, tëmthin dhe fshikëzën e urinës duke lehtësuar kështu nxjerrjen e toksinave të dëmshme nga organizmi.

Mënyrat e konsumit të hithrës


Hithra mund të gatuhet si çdo barishte tjetër. Ajo valohet dhe konsumohet si sallatë ose përfshihet në gatimet e brumit.

Hithra duhet mbledhur nga vende të sigurta ku nuk janë përdorur pesticide.

Ato të rritura në natyrë janë më të shëndetshme thonë ekspertët.

Me hithrën mund të përgatishni edhe një çaj të shëndetshëm e të pasur me vitamina dhe minerale. Vendosni hithrat, të thata ose të freskëta, në një çajnik.

Hidhni ujë dhe vendoseni çajnikun në zjarr.



Për një filxhan me hithra, ju nevojiten 2 filxhanë me ujë. Çajin mund ta bëni të fortë duke hedhur më pak ujë, ose më të lehtë duke hedhur më shumë

ujë. Sapo uji të nisë të ziejë, hiqeni nga zjarri dhe lëreni të ftohet për pak minuta. Më pas kullojeni dhe hidhni në

filxhan. Disa njerëz preferojnë të shtojnë pak sheqer, por mjalti është një zgjidhje ideale.

AgroWeb.org

Sezoni i qumështit të bletës - Shëruesi magjik i shumë sëmundjeve

Përdorimi i qumështit të bletës po njuh një zgjerim të konsiderueshëm në tregun tonë

Çdo pikë qumështi i bletës është jetë. Vlerësohet si nektari i perëndive për nga vlerat e jashtëzakonshme shëruese që ka për shëndetin.

Pikërisht qershori është muaji në të cilin ky produkt prodhohet dhe fillon të shitet nga bletarët, prandaj dhe këshillohet që të konsumohet në këtë periudhë.

I njohur ndryshe me emrin "Xhelatina Mbretërore" qumështi i bletës është ndër më të kërkuarit në botë. Sot ai është shndërruar në një biznes fitimprurës për bletarët krahas prodhimit të mjaltit. Sipas të dhënave, vitet e fundit, qumështi i Bletës po njuh një zgjerim të konsiderueshëm në tregun tonë.

Ashtu si në çdo vend të botës ai shitet në sasi shumë të kufizuara ndaj vlera e tij përherë e më shumë bëhet më e shtrenjtë. Ai ambalazhohet në minishishe qelqi dhe shitet në gramatura shumë të vogla.

Sipas të dhënave të AgroWeb.org çmimi mesatar për vetëm një gram qumështi të bletës shkon deri në 10 euro.

Nisur për nga vlera e lartë dhe fitimprurëse, bletarët kanë fokusuar biznesin e tyre prej disa

vitesh edhe në shitjen e qumështit të bletës ndërsa e vlerësojnë këtë mënyrë biznesi edhe më fitimprurës se sa shitja e mjaltit.

Kërkesa për qumështin e bletës në rritje


Bletarët shprehen se kërkesa për qumështin e bletës është gjithnjë në rritje ndaj dhe ata janë duke i kushtuar vëmendje përherë e më të lartë nxjerrjes së këtij qumështi të artë.

Vjelja e qumështit të bletës kërkon një mjeshteri të posaçme pasi i gjithë procesi është shumë delikat.

Qumështi i bletës që prodhohet nga gjëndrat e bletëve punëtore shërben për të ushqyer larvat gjatë tri ditëve të para si dhe për të ushqyer mbretëreshën.

Ky ushqim e mban mbretëreshën në jetë për 8 vjet, një fakt interesant ky, duke ditur që një bletë e zakonshme, e cila ka lindur nga e njëjta vezë me mbretëreshën, jeton vetëm 21 ditë.

Qumështi i bletës ka ngjyrë të bardhë në të verdhë, është si krem, ka shije të thatë dhe pak aromë.



Vlerat kurative për shëndetin

Vlerësohet si një super ushqim i fuqishëm për shkak të vlerave që ai mbart. Qumështi i Bletës përmban ujë, lëndë minerale, yndyrna, proteina, karbohidrate, vitamina etj.

Ai mund të përdoret për kurimin e një sërë sëmundjesh si: Hipertiroidizem, Diabeti, Hiperkolesterolemi, hipertrigliceridemi (kolesterol dhe trigliceride të larta), sëmundje të zemrës dhe enëve të gjakut, sëmundje kronike të mushkërive, sëmundje të gojës, probleme me mishrat e dhëmbëve, probleme të fytit, sëmundje të veshkave, artrite reumatoide, probleme me

riprodhimin, ndihmon në periudhat e premenopauzës etj. Ai rekomandohet që të përdoret herët në mëngjes duke e marrë nën gjuhë. Kjo pasi aty ka mjaft enë gjaku që bëjnë thithjen e menjëhershme dhe kalimin në gjak.

Zgjatja e kurimit është e ndryshme dhe varet nga shkalla e sëmundjes ose qëllimi për të cilin përdoret, por asnjëherë më pak se një muaj.

Ka efekt qetësues dhe çlodhës, ul nivelin e hormoneve të tiroides. Ai është një pastrues fantastik për organizmin nga toksinat.

Ndihmon funksionimin e veshkave, rrit jetëgjatësinë e njerëzve, duke ruajtur rininë e enëve të gjakut. Zgjeron enët e

gjakut, ndihmon në uljen e kolesterolit dhe triglicerideve dhe rrit imunitetin.

Ky qumësht ndihmon në formimin e ruazave të kuqe të gjakut, këshillohet në anemi dhe ndihmon në mikrohemorragji. Në lëkurë, rregullon prodhimin e yndyrës.

Përdoret në kozmetikë, sepse ndihmon në pastrimin dhe rinimin e lëkurës. Përdoret si agent antibakterial dhe antiviral lokal për probleme të ndryshme të lëkurës. Te fëmijët e sapolindur ndihmon në rritjen në peshë.

Qumështi i bletës, nxit gjëndrat riprodhuese, ndihmon prodhimin e vezoreve, gjatë shtatzanisë, duke rritur nivelin e progesteronit në gjak.


Rrit nivelin e testosteronit në gjak, duke ndihmuar në problemet e potencës mashkullore. Stimulon gjëndrat mbiveshkore dhe ndihmon në sëmundje si artriti ose lodhja kronike.

Ndihmon në funksionimin e mëlçisë dhe sëmundjet e saj, hepatite dhe rigjeneron strukturën e mëlçisë.

Rekomandohet që kura duhet të zgjasë një muaj, maksimumi tre muaj, ndërkohë që dozat kurative duhet të ndërmerren sipas specifikimeve përkatëse.

Vlerësohet se asnjë ilaç nuk mund të zëvendësojë vlerat kurative të Qumështit të Bletëve.

AgroWeb.org



Majlinda, e artë në Abu Dhabi

PRISHTINË, 24 TETOR (ER) - Xhudistja më e mirë e Kosovë, Majlinda Kelmendi, e ka fituar medaljen e artë në Grand Slam-in e Xhudos, i cili po mbahet në Abu Dhabi të Emirateve të Bashkuara Arabe. Kampionia Olimpikë (-52 kg) e mposhti me ipoon italianen Odette Giuffrida, pas një lufte të ashpër që zgjati rreth 10

minuta. Majlinda italianen e kishte mundur edhe në finalen e Lojërave Olimpikë Rio 2016. Në përgjithësi, Majlinda fitoi pesë luftëra, të cilat i sjellin edhe 1 000 pikë olimpikë për Lojërat Olimpikë "Tokyo 2020". Kampionia olimpikë mposhti garueset Fofana (Bregu i Fildishtë), Kazyulina (Kazakistan), Park (Kore e

Jugut), Chelsie Gilles (Britani e Madhe) dhe Odette Giuffrida (Itali). Ndryshe nga Majlinda, Nora Gjakova shënoi një fitore, por më pas u ndal në rrethin e tretë nga Hyo Son (Kore e Veriut). Sot (e premte) garon xhudisti Akil Gjakova në kategorinë -73 kg, ndërsa nesër (e shtunë) garon xhudistja Loriana Kuka.



Kosova ngritët, Shqipëria bie në renditjen e FIFA-s

"Dardanët" me pesë pozitat e fituara në renditjen e re të FIFA-s e kanë regjistruar kështu pozitën më të mirë që nga anëtarësimi në FIFA në maj të vitit 2016. "Në listën e re Kosova ka arsye të reja për të festuar (e radhitur në vendin e 114-t, pesë pozita më lart). Ata mund të jenë sërish krenarë me arritjen e pozitës më të mirë në këtë listë deri më tani", ka shkruar FIFA

"Epoka e re"

PRISHTINË, 24 TETOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll e ka vazhduar ngritjen në renditjen e FIFA-s. "Dardanët" tashmë renditen në pozitën e 114-t, duke u ngritur kështu për pesë vende në krahasim me renditjen e muajit të kaluar. Ky përparim i Kosovës vjen falë fitores kundër Malit të Zi në kualifikimet për "Euro 2020",

por edhe fitores në miqësoren kundër Gjibraltarit, ndeshje të cilat "Dardanët" i zhvilluan gjatë muajit tetor. Në këto dy fitore Kosova arkëtoi 20 pikë në renditjen e FIFA-s dhe tashmë ka 1 184 pikë, duke e regjistruar kështu pozitën më të mirë që nga anëtarësimi në FIFA në maj të vitit 2016.

Përfaqësuesen e Kosovës në muajin e ardhshëm e presin dy ndeshje jashtëzakonisht të rëndësishme, ajo kundër



Çekisë, më 14 nëntor në Plzen dhe kundër Anglisë, më 17 nëntor në Prishtinë, nga epilogu i të cilave varet kualifikimi ose jo në Kampionatin

Evropian. "Në listën e re Kosova ka arsye të reja për të festuar (e radhitur në vendin e 114-t, pesë pozita më lart). Ata mund të jenë sërish krenarë

me arritjen e pozitës më të mirë në këtë listë deri më tani", ka shkruar FIFA.

Në renditjen e FIFA-s ka pasur rënie për një pozitë Shqipëria. Kombëtarja kuqezi ka humbur një pozicion në renditje krahasuar me muajin e kaluar dhe tash pozicionohet e 65-ta. Në krye të listës qëndron Belgjika, e ndjekur nga Franca dhe Brazili. E katërta në grup është Kombëtarja e Anglisë, e cila është kundërshtarë e Kosovës në Grupin A për kualifikimet në "Euro 2020". Në vendin e pestë pozicionohet Uruguai, më pas janë Portugalia, Kroacia, Spanja, Argjentina dhe e dhjeta gjendet Kolumbia. Dy kombëtarët më të madh, Italia dhe Gjermania, renditen në pozitën e pesëmbëdhjetë dhe gjashtëmbëdhjetë.

Muriqi, objektivi i Interit



PRISHTINË, 24 TETOR - Sulmuesi i Përfaqësueses së Kosovës në Futboll, Vedat Muriqi, po kalon nëpër formën jetësore. Muriqi, i transferuar me shumë bujë gjatë verës në skuadrën e Fenerbahçes, ka shënuar katër gola në tetë ndeshjet e zhvilluara në Superligën e Turqisë. Duke parë formën e tij në klubin turk dhe në Përfaqësuesen e

Kosovës shumë skuadra evropiane janë futur në garë për t'i siguruar shërbimet e tij. Atletico Madridi, Tottenham Hotspur dhe Lazio ishin skuadrat e interesuara për sulmuesin shtatlartë, kurse kësaj gare i është shtuar edhe Interi. Kapiteni i Turqisë, Emre Belozoglu, që është bashkëlojtar i Vedat Muriqit, ka thënë se nuk

është befasi që skuadrat e mëdha evropiane interesohen për sulmuesin e Lirisë së Prizrenit. "Vedat Muriqi është golashënues i madh. Nuk është befasi që po e kërkon Evropa dhe që gjigantët e kanë në radar. Ai meriton këtë vëmendje. Besoj se ai do t'i shërbejë fanellës verdhekalte për disa vjet dhe do të ketë sukses", ka thënë Emre.

Ballkani iu rikthehet fitoreve në Superligë

SUHAREKË, 24 TETOR - Ballkani, pas humbjes nga Drita në xhiron e kaluar, të enjten u është rikthyer fitoreve në përballje me Flamurtarin. Skuadra nga Suhareka e mposhti skuadrën

kuqezi nga Prishtina me rezultat 3-1. Blend Baftiu shënoi në pjesën e parë për 1-0, kurse Artur Magani e dyfishoi epërsinë e vendësve 2-0 në minutën e 59. Pesë minuta më vonë

realizoi edhe Jetmir Topalli, i cili ishte golashënuesi i tretë për skuadrën e Ismet Munishit në këtë ndeshje, kurse për mysafirët golin e vetëm në ndeshje e realizoi Angel

Grancov. Pas kësaj ndeshje Ballkani ka grumbulluar 23 pikë dhe zë vendin e dytë. Flamurtari mbetet në kuotën e nëntë pikëve dhe renditet në pozitën e dhjetë.



Briatore: Ferrari duhet t'i besojë Leclercit para Vettelit

MONACO, 24 TETOR - "Leclerc është më i shpejtë se Vetteli. Është një pilot i destinuar për t'u shpallur kampion bote. Nëse unë do të isha shef i Ferrarit do të mbaja dhe

përqendrohesh më shumë te Leclerc. Do ta lija atë pilot të parë dhe do të hiqja dorë nga Vetteli". Ka qenë kjo deklarata e dhënë nga Flavio Briatore, ish-drejtuues në Formula 1. Ai

shpjegon zgjedhjen e tij. "Leclerc është një talent, agresiv në pistë dhe arrin të marrë më shumë nga makina. Çdo makinë duhet ta zgjedhë pilotin që do të mbështesë për

titullin dhe një tjetër që do të jetë në dispozicion të tij. Vetteli mund të qëndrojë te Ferrari, është një pilot i madh, por vetëm si pilot i dytë", ka pohuar Briatore.



Dallku: Kemi ambicie të mëdha me Shkëndijën

TETOVË, 24 TETOR - KF Shkëndija e ka siguruar përforcimin e parë për afatin kalimtar të dimrit pasi që tani është firmosur kontratë me mbrojtësin nga Kosova, Ardin Dallku. "KF Shkëndija me kënaqësi konfirmon gjetjen e akordit të bashkëpunimit me mbrojtësin kosovar Ardin Dallku. Në fakt, është një lëvizje që do të hyjë në fuqi në mënyrë juridike në janar të vitit të ardhshëm kur futbollisti 24-vjeçar do të fitojë të drejtë loje", thuhet në njoftimin e klubit kuqezi.

Ardin Dallku vjen nga kampionati ukrainas ku u paraqit vite me radhë me ekipin Vorskla Poltava.

"Jam i lumtur që në të ardhmen do të luaj për një klub si Shkëndija. Gjatë kohës isha pjesë e kampionatit ukrainas dhe jam shumë i motivuar për këtë përvojë të re. E di se Shkëndija ka ambicie të mëdha. Unë gjithashtu premtoj të jap gjithçka nga vetja për ta ndihmuar ekipin t'i realizojë objektivat", shprehet Ardin Dallku.

24-vjeçari luajti me shpresat e Prishtinës para se në vitin 2012 të transferohej në Ukrainë, fillimisht te ekipi i të rinjve. Deri në vitin 2016 luante me juniorët, para se të kalonte në ekipin e parë kur për tre vjet regjistroi 60 paraqitje dhe

shënoi 2 gola. Vendimin e Ardin Dallkut për të mos vazhduar me Vorskla dhe shfrytëzoi Shkëndija që e afron kosovarin në skuadër. Dallku tashmë është bashkuar me kuqezinjtë në seancat stërvitore, madje duke lënë pas vetes 45 minutat e para me fanellën e Shkëndijës në miqësoren me Dritën e Gjilanit (29 shtator) ku luajti në pjesën e dytë dhe shënoi golin e fundit në fitoren 4:0. Ai do të punojë gjithë kohën me grupin nën urdhrat e trajnerit Ernest Gjoka, për ta pritur i akomoduar dhe sa më i përgatitur gjysmëstatorin pranveror kur fiton të drejtë loje.



Rossi para garës së 400: Jam një gjysh në Moto GP, por dua të fitoj

ROMË, 24 TETOR - Këtë fundjavë do të zhvillohet gara e Çmimit të Madh të Australisë në Moto GP. Kjo do të jetë gara e 400 në këtë kategori për pilotin italian Valentino Rossi. "Është e bukur të arrij këtë shifër, mbi të gjitha në një pistë ikonë të Moto GP. Kur debutova në këtë sport nuk e kisha imagjinuar kurrë se do të arrija deri këtu", ka thënë Rossi. "Kur debutova në këtë sport, nëse do të shihja një pilot 40-vjeçar që garonte, do ta konsideroja gjysh. Tani ai gjysh jam unë. Megjithatë, jam i motivuar ende për të fituar dhe kjo më bën të garoj", u shpreh piloti italian, me nëntë tituj të fituar. "Kur je i ri nuk mendon se do të garosh kaq gjatë në një sport. Nuk i ke idetë e qarta, por tani



është ndryshe. Kur debutova isha 17-vjeçar, kisha gjithë jetën përpara. Tani jam një gjysh që ndihem po aq i ri në zemër si ata që garojnë për herë të parë.

Sot në Moto GP duhet të vendosim për të ardhmen dy vjet më herët ndaj më duhet të mendoj edhe për vitin 2021", ka deklaruar Rossi.

SHKURT

Unitedi sërish mendon për transferimin e Mullerit

Thomas Mulleri paralajmëroi se mund të largohet që në muajin janar nga Bayern Muncheni. Gjermani, i cili gjatë gjithë karrierës ka luajtur për "bavarezët", duket se është lodhur dhe tashmë kërkon të ndryshojë ambient. Prestigjiozja "Bild" raporton se Manchester Unitedi është futur në garë për shërbimet e 30-vjeçarit. "Djajtë e Kuq" po vuajnë jo pak në sulm dhe duket se po mendojnë seriozisht ta transferojnë Thomas Mullerin për t'i zgjidhur problemet e ofensivës. Unitedi e kishte kërkuar Mullerin edhe në vitin 2014, por atëkohë Bayerni nuk kishte lejuar largimin e tij.

McGregor nuk pensionohet, rikthehet më 18 janar

Conor McGregor ka thënë se më 18 janar të vitit 2020 do ta bëjë rikthimin e tij në UFC, pavarësisht njoftimit për pensionim nga sporti i arteve marziale këtë vit.

31-vjeçari nuk ka luftuar në oktagon që nga humbja e pësuar nga Khabib Nurmagomedov në UFC 229 në tetor të vitit 2018. McGregor në konferencë për shtyp ka thënë se është në gjendje të mirë fizike. "Data është caktuar. Unë nuk merakosem se kush do të jetë kundërshtari im. Duhet 66 ditë për të krijuar një zakon. Tani unë shkoj herët në shtrat dhe, po ashtu, ngrihem herët", ka thënë McGregor.

Napoli në bisedime me Ibrahimoviçin

Presidenti i Napolit, Aurelio De Laurentiis, prej kohësh ka qenë i interesuar që të nënshkruajë me sulmuesin suedez Zlatan Ibrahimoviç. Ai tani ka bërë me dije se bisedimet për një transferim të mundshëm janë duke u zhvilluar "për disa muaj", shkruan "Goal". Ndërsa futbollisti 38-vjeçar ka lënë të kuptohet se mund të rikthehet në Serinë A, pasi kontrata e tij me LA Galaxy të ketë skaduar.

Dy klube angleze e kërkojnë Suson

Suso është gati t'i thotë lamtumirë Milanit që në afatin kalimtar të janarit. Siç raporton "The Sun", Wolverhampton Wanderers dhe West Ham United janë dy skuadrat që janë gati ta rrëmbejnë nga Milani. Klauzola e lojtarit është 40 milionë euro dhe për kuqezinjtë kjo shifër do të ishte e kënaqshme nëse do të merrej. Kjo shifër do ta ndihmonte shumë klubin të përfitonte disa të ardhura dhe të vendoste balancën në financa. Mbetet të shihet nëse spanjollli do të largohet në janar apo do të qëndrojë në skuadrën kuqezi.

Favre: Interi fitoi pa krijuar asgjë

Trajneri i Borussia Dortmundit, Lucien Favre, nuk pajtohet që Interi fitoi 2-0 kundër skuadrës së tij në Ligën e Kampionëve, pasi beson se skuadra italiane nuk ka krijuar asgjë deri njëzet minuta para fundit. "Ne i respektojmë të gjithë, sepse e dimë se jemi në një grup të vështirë. Ne luajmë mirë, ishim të qëndrueshëm dhe nuk bëmë lëshime. Ata shënuan nga gabimi ynë, por pa krijuar asnjë rast të mirë në pjesën e parë dhe në fillim të pjesës së dytë. Deri në minutën e 70 Interi nuk krijoi gati asgjë. Ne rrezikuar dhe e ekspozuam veten në kundërsulme", ka thënë Favre.

Conte: Dortmundi u frikësua nga Interi

Trajneri i Interit, Antonio Conte, ka thënë se Borussia Dortmundi ishte e frikësuar dhe ndryshoi sistemin e lojës ndaj Interit në kuadër të Ligës së Kampionëve. Conte bëri me dije se Interi ishte i përgatitur për një ndeshje tjetër, mirëpo skuadra gjermane ishte e frikësuar nga ta dhe ndeshja ndryshoi. "Borussia e ndryshoi sistemin e tyre me pesë mbrojtës, që nënkupton se ata ishin të frikësuar nga ne dhe dëshironin ta kopjonin lojën tonë. Ne ishim të përgatitur për një tjetër ndeshje, por ne bëmë gjërat shumë mirë. Kur Dortmundi shkante për 4-2-3-1 pas pushimit, ne morëm kontrollin e lojës edhe më shumë", ka thënë Conte. "Kemi bërë presion gjatë gjithë kohës dhe ata ndryshuan sistemin e tyre, për të na lehtësuar punën edhe më shumë. Gjëja më e rëndësishme ishte që mos ta humbim posedimin e topit dhe atë gjë e bëmë si duhet", ka shtuar Conte.



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit të datës 22.10.2019 për Ri-shpalljen e konkurseve, dhe gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendeve të punës për periudhën e ardhshme një vjeqare, KRM "Uniteti" SLLA vendosi që me datë 25.10.2019 të rishpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të punës:

Punëtor Fizik me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeqare), me mundësi vazhdimi

2-Punëtor fizik - Njësia në Mitrovicë

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e mbeturinave në automjete – kamion kompaktor dhe traktor,
- Zbrazen e konteinerëve dhe pastrimin e lokacionit rreth tyre nga zona e shërbimit gjerë në deponi.
- Kryen pastrimin, larjen dhe spërkatjen e sipërfaqeve publike, rrugëve dhe shesheve.
- Kryen punët e grumbullimit të mbeturinave në konteiner, kryen punët rreth pastrimit të borës, hedhjes së kripës industriale, heqjen e akullit,
- Është i obliguar të ketë sjellje korrekte ndaj qytetarëve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve.
- Është përgjegjës për përdorim të kujdesshëm të konteinerëve gjatë punës, kryen edhe punë tjera të natyrës së ngjashme të cilat i cakton udhëheqësi i tij i drejtëpërdrejtë.

Kualifikimet e kërkuara:

- Të ketë së paku një vit përvojë pune
- Të prezantoj letërnjoftimin
- Çertifikatë nga gjykata se nuk jeni i denuar (më e re se 3-6 muaj)

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj. mund të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë. Konkursi do të jetë i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 25.10.2019 deri më datën 09.11.2019. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.

Kërkesa për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Fehmi Rama"

Komuna: Skenderaj

Data: 25.10.2019

| | |
|---------------------|--|
| Numri i kontratës: | Emri i kontratës: |
| ESIP/SDG/111-CS/1.2 | Trajnim: Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie |

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shfmu "Fehmi Rama" Likoc, Skenderaj

Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme:

Trajnim: Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie

Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Përvojë në trajnimin e mësimdhënësve dhe personelin e shkollës
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme.

Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e teknologjisë (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).

Firmat konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën Shfmu "Fehmi Rama" Likoc, Skenderaj, më së largu deri më datën; 04.11.2019

Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Arsim Jusufi

Telefoni: 044/549-732

E-maili: arsimjusufi@hotmail.com



Kompania Regjionale e Mbeturinave K.R.M. "Uniteti" SH.A. Mitrovicë

NJOFTIM PËR VAZHDIMIN E AFATIT TË KONKURISIT

Kompania Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" Sh.A - Mitrovicë zgjatë afatin edhe për shtatë ditë kalendrike për aplikim të kandidatëve për pozitën :

Zyrtar/e për Mbrojtjen e Ambientit - Konkursi i shpallur me datë 05.10.2019 në gazetën ditore Epoka e Re.

Për arsye se nuk është arritur numri i duhur i aplikacioneve.

Afati i konkurimit vazhdohet prej datës 25.10.2019 deri me datë 01.11.2019 deri në orën 16:00.

Vërejtje:Kandidatët që kanë aplikuar më herët në këtë pozitë të punës, nuk kanë nevojë të aplikojnë përsëri. Formularin zyrtar për aplikim dhe informata tjera shtesë mund ta gjeni në zyrën e Arkivës pranë K.R.M "Uniteti" Sh.A. - Mitrovicë

Kërkesa për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Skender Skenderi"

Komuna: Skenderaj

Data: 25.10.2019

| | |
|---------------------|--|
| Numri i kontratës: | Emri i kontratës: |
| ESIP/SDG/120-CS/1.3 | Trajnim: Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie |

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shfmu "Skender Skenderi" Vojnik, Skenderaj

Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme:

Trajnim: Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie

Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Përvojë në trajnimin e mësimdhënësve dhe personelin e shkollës
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme.

Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e teknologjisë (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).

Firmat konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën Shfmu "Skender Skenderi" Vojnik, Skenderaj, më së largu deri më datën; 04.11.2019

Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Halil Thaqi

Telefoni: 044712641

E-maili: halilth@live.com

Njoftim për shprehje të interesit
Emri i shkollës: "Osman Mani"

Komuna: Shtërpçë
Data: 24.10.2019

| | |
|-------------------------|---------------------------------|
| Numri i kontratës: | Emri i kontratës: |
| ESIP/SDG/103-CS/1.1-1.2 | Trajnim: Gjithëpërfshirja - PIA |

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe SHFMU "Osman Mani" në Firajë, Shtërpçë.

1.Përshkrimi i shërbimeve të nevojshme:
Trajnim: Gjithëpërfshirja – PIA

2.Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvojë në trajnimin dhe punën me personelin e administratës publike ose komunale
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e Gjithëpërfshirjes.:

Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulentëve nga fusha e Gjithëpërfshirjes (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).

Firmat Konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesimit për shërbime konsulente në adresën: SHFMU "Osman Mani" në Firajë, Shtërpçë , më së largu deri më 01.11. 2019.

1. 4. Firmat e interesuara të konsulentëve mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

Detajet kontaktuese të shkollës:
Personi kontaktues: Ganimete Xhemajli
Telefoni: 044380029
E-maili: ganimetexhemajli@hotmail.com

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania N.T.P. "Guri i Kuq" Dobrushtë, Prizren, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për fabrikën për prodhimin e peletit dhe përpunim i drurit në Dobrushtë komuna e Prizrenit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 22.11. 2019 në ora 11:00 në lokalet e kompanisë "Guri i Kuq" në fshatin Dobrushtë komuna e Prizrenit do të organizohet debat publik nga kompania N.T.P. "Guri i Kuq" Dobrushtë, Prizren, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për fabrikën për prodhimin e peletit dhe përpunim i drurit në Dobrushtë komuna e Prizrenit.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality
Drejtorati për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit
- Shërbimi pronësoro juridik – Komisioni për Shpronësim
Direktorijati za Urbanizam, Katastar i Zastitu Zivotne Sredine
- Imovinska pravna sluzba – Komisija za Eksprijacijju



04. Nr.465-1/2009
Date 18.10.2019

Drejtorati për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit-Shërbimi Pronësoro-Juridik, duke vepruar sipas Vendimit të KK-së Dragash 01 Nr.020-888 të dt.03.08.2019, me qëllim të shpronësimit për destinim të Varrezave të fshatit Brezne, Komuna e Dragashit, në lëndën e shpronësimit Nr. 465-1/2019 në kuptim të nenit 4,8,9, dhe 10, të Ligjit nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës se Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr.03/L-205, me datë 18.09.2019, merrë :

VENDIM PRELIMINAR

1. Miratohet Shpronësimi për interes publik i pronës të paluajtshme të pronareve dhe zotuesëve të interesit që preken nga Shpronësimet për interesin publik, për shfrytëzim të pronës për varreza në fshatin Brezne, Komuna e Dragashit e cila sipas Vendimit është shpronësimi i ngastres kadastrale në tërësi, me të dhëna nga elaborati/evidences kadastrale siq vijon :

Objekti i Shpronësimit: ngastra kad. 01676-0 në tërësi, ZK Brezne me kulturë livadhë i klasës 5, sipërfaqja 5286m², që në elaboratin kadastral evidentohet në emrin: Aziz (Rakip) Krasniqi 1/3, Përparim(Rakip)Krasniqi 1/3 dhe Lulzim (Rakip) Krasniqi 1/3, të gjithë nga fshati Brezne;

2.Obligohet Komisioni për Shpronësim qe brenda 5 (pese) ditëve të punes, pas nënshkrimit të ketij Vendimi Preliminar, ti njoftoj pronaret dhe pretenduesit e tokave te cilat do te Shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 (dhjet) diteve të punes pas miratimit te njejtin do ta shpalle ne Gazeten Zyrtare te Kosovës dhe një gazet me tirazh te madhë ne Kosovë;

3.Kundër ketij Vendimi, apo cilës do pjese të tij kane të drejte të paraqesin ankese brenda (15) diteve kalendarike ne Gjykatën Themelore Prizren-dega në Dragash, subjekti kerkuës dhe cilido person i cili është pronar ose zoterues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky Vendim;

4. Për zbatimin e ketij Vendimi obligohet Drejtorati për Urbanizëm...-Shërbimi Pronësoro-Juridik;

5.Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare te Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madhë në Kosovë.



Kryetari i Komunës:

Shaban Shabani



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit / Opština Dragaš / Municipality Dragas
Drejtorati për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit- Shërbimi pronësoro juridik
Direktorijati za Urbanizam, Katastar i Zivotnu Sredinu - Imovinska pravna sluzba



04 Br.465-1/2019
18.10.2019

Direktorat za Urbanizam Katastar i Zastitu Zivotne Sredine – Imovinsko Pravna Sluzba postupajuci po Odluci SO-e Dragas, 01 br.020-888 të dt.03.08.2019 god, radi eksprijacijje u svrhu gradnje seoskog Groblja u selu Bezna, Opština Dragas na osnovu cl.8, stav 5, Zakona o Esprorijaciji nepokretne inovine Br.03L-139 sa izmenama i dopunama iz Zakona br.03/L-205, od dana 18.10.2010, donosi:

PRELIMINARNU ODLUKU

1. Odobrava se eksprijacijja u svrhu javnog interesa , nepokretne imovine vlasnika ili posednika interesa koji su pogodjeni potrebom za obezbedjenjem površine za groblje u selu Brezna , Opština Dragas prema podatcima iz odgovarajucih katastarskih evidencija , gde je predmet eksprijacijje kako sledi :

Predmet Eksprijacijje : cela kat. parcela 01676-0 ZK Brezna po kulturi livada 5 klase, površine 5286m², koje se u kat.elaboratu vode na ime : Aziz (Rakip) Krasniqi 1/3 , Përparim(Rakip)Krasniqi 1/3 i Lulzim (Rakip) Krasniqi 1/3 , svi iz sela Brezna ;

2. Imovinsko Pravna Sluzba shodno Odluci SO-e Dragas, 01 br.020-888 od dt.03.08.2019 god je obavezna da unutar roka od 5 (pet) radnih dana nakon potpisivanja ove Odluke , obavesti vlasnike odnosno posednike parcele koja ce se eskorporiosati, a u roku od 10 (deset) radnih dana nakon usvajanja ove Odluke, ista ce se objaviti u Sluzbenom Listu Kosova i u jednoj od najtiraznijih dnevnih novina na Kosovu;

3.Protiv ove Oluke ili biko kojeg njenog dela moze se upoutiti zalba unutar roka od 15 kalenadarskih dana od stupanja na snagu , Nadleznom Sudu, od strane pzodnosioca zahteva za eksprijacijjom i bilo kojeg lica – vlasnika ili posednika intersa nad nepokretnom imovinom pogodjenom ovom Odlukom; Istog dana nakon protokolisanja zalbe u Onosvnom Sudu Prizren –ogranak Dragas , navedena lica ili njihovi ovlasцени zatupnici predaju 5 primeraka protoklisane zalbe Imovinsko-pravnoj sluzbi.

4. Za provodjenje ove Odluke je nadlezan je gore opisati Direktorat, odnosno sluzba ;

5. Ova Odluka stupa na snagu danom objavljivanja u Sluzbenom Listu Kosova i u jednim od najtiraznih novinama na Kosovu .



Predsednik Opštine
Shaban Shabani



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC COLA
Columbus, Georgia, USA
Since 1909